



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.31

31 mars

2011

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Ligj nr.10 388 datë 3.3.2011	për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9126, datë 29.7.2003 “Për përdorimin civil të lëndëve plasëse në Republikën e Shqipërisë” 1091
Ligj nr.10 389 datë 3.3.2011	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9668, datë 18.12.2006 “Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi” 1093
Ligj nr.10 390 datë 3.3.2011	Për plehrat e përdorimit për bimësinë 1098
Ligj nr.10 391 datë 3.3.2011	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” 1107
Ligj nr.10 392 datë 10.3.2011	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë, përfaqësuar nga Ministri Federal i Financave, për bashkëpunimin financiar” 1112
Ligj nr.10 393 datë 10.3.2011	Për ratifikimin e “Marrëveshjes së kredisë së eksportit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Unicredit Bank Austria për financimin e përmirësimit të departamentit të Neurokirurgjisë për Spitalin Universitar “Nënë Tereza”” 1115

LIGJ
Nr.10 388, datë 3.3.2011

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9126, DATË 29.7.2003 “PËR
PËRDORIMIN CIVIL TË LËNDËVE PLASËSE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.9126, datë 29.7.2003 “Për përdorimin civil të lëndëve plasëse në Republikën e Shqipërisë”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në titullin e ligjit, pas fjalëve “lëndëve plasëse” shtohen fjalët “dhe lëndëve piroteknike dhe fishekzjarrë”.

Neni 2

Në nenin 1, pas fjalëve “mënyrën e tregtimit” shtohen fjalët “si dhe regjistrimin e gjurmimit”.

Neni 3

Në nenin 2, pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Dispozitat e këtij ligji, të cilat rregullojnë prodhimin, importin, eksportin dhe magazinimin e lëndëve plasëse për përdorim civil, zbatohen edhe për prodhimin, importin, eksportin dhe magazinimin e lëndëve piroteknike dhe fishekzjarrë.

Nuk zbatohen, për lëndët piroteknike dhe fishekzjarrë, dispozitat e këtij ligji për regjistrimin, gjurmimin, transferimin dhe përdorimin e lëndëve plasëse për përdorim civil.”.

Neni 4

Në nenin 3 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 2, fjalia e dytë ndryshohet si më poshtë:

““Lëndë plasëse për përdorim civil” janë materialet dhe artikujt e përcaktuar si të tillë në “Rekomandimet e Kombeve të Bashkuara për transportin e mallrave të rrezikshme”, ratifikuar me ligjin nr.9272, datë 16.9.2004 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen europiane “Për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave të rrezikshme, ADR” dhe protokollin e nënshkrimit”, dhe që nuk bëjnë pjesë në listën e mallrave ushtarake e të mallrave me përdorim të dyfishtë, miratuar në zbatim të ligjit nr.9707, datë 5.4.2007 “Për kontrollin shtetëror të veprimtarisë së import-eksportit të mallrave ushtarake dhe mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë””.

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Lëndët piroteknike dhe fishekzjarrë për përdorim civil, që lejohen të importohen, eksportohen apo prodhohen në Republikën e Shqipërisë, janë ato mallra, transformimi i të cilave bëhet vetëm me djegie, me shpejtësi 1-10 m/sek, të cilët lëshojnë flakë dhe dritë, me ndriçim, me ngjyra të ndryshme, dhe që përcaktohen në pjesën II, klasa I, grupet 3 e 4, me kod klasifikimi 1.3G ose IAG, siç parashikohet në marrëveshjen europiane për transportin rrugor ndërkombëtar të mallrave të rrezikshme (ADR), ratifikuar me ligjin nr.9272, datë 16.9.2004.”.

3. Në pikën 7, pas fjalëve “përdorim civil” shtohen fjalët “brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, duke përjashtuar këtu spostimet brenda së njëjtës strukturë.”.

4. Pas pikës 8 shtohen pikat 9, 10 dhe 11 me këtë përmbajtje:

“9. “Siguria publike”, në kuptim të këtij ligji, është parandalimi i përdorimit të kundërligjshëm dhe kundër rendit publik.

10. “Gjurmimi” është një sistem i përshtatshëm identifikimi për përcaktimin e saktë të vendndodhjes së lëndëve plasëse për përdorim civil, nga prodhimi apo importimi deri te përdorimi i fundit, si dhe të poseduesit të saj në të gjitha fazat.

11. “Regjistrim” është sistemi ku hidhen të dhënat, për hyrjet e daljet nga territori i Republikës së Shqipërisë të lëndëve plasëse për përdorim civil, si dhe për lëvizjet (shitblerjet) brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, deri tek identifikimi i përdoruesit të fundit.”.

Neni 5

Në nenin 4 pika 1 fjala “kryesore” hiqet.

Neni 6

Në nenin 7 pika 5, pas fjalëve “të gjitha masat” shtohen fjalët “për regjistrimin, gjurmimin dhe identifikimin e lëndëve plasëse në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe”.

Neni 7

Pas nenit 7 të kreut III shtohet neni 7/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 7/1

Lëndët piroteknike e fishekzjarrë për përdorim civil

1. Këshilli i Ministrave përcakton procedurat për dhënien e licencës për prodhimin, importimin, eksportimin, magazinimin e lëndëve piroteknike dhe fishekzjarrë.

2. Ministria e Mbrojtjes kontrollon, verifikon, ndjek dhe zbaton prodhimin, importimin dhe eksportimin e lëndëve piroteknike e fishekzjarrë dhe përcakton, me rregullore të veçantë, mënyrën, kushtet dhe kriteret.

3. Ministria e Brendshme kontrollon, verifikon, ndjek dhe zbaton magazinimin e lëndëve piroteknike e fishekzjarrë dhe përcakton, me rregullore të veçantë, mënyrën, kushtet dhe kriteret.”.

Neni 8

Në nenin 9 pika 4, fjalët “60 ditë” zëvendësohen me fjalët “7 ditë”.

Neni 9

Neni 10 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 10

Gjurmimi dhe identifikimi i lëndëve plasëse

1. Subjektet tregtare, në fushën e prodhimit, importimit, eksportimit, përdorimit dhe asgjësimit të lëndëve plasëse për përdorim civil, të disponojnë një sistem efikas të gjurmimit të lëndëve plasëse për përdorim civil. Ky sistem të mundësojë identifikimin, në çdo fazë, të posedimit të këtyre mallrave, nga prodhimi, importimi, hedhja në treg për herë të parë dhe deri te përdorimi i fundit i tyre.

2. Ministria e Mbrojtjes merr të gjitha masat që subjektet me veprimtari tregtare në sektorin e lëndëve plasëse të pajisen më një sistem për mbledhjen e të dhënave, i cili të përfshijë identifikimin unik dhe poseduesin e tyre, gjatë gjithë fazave të procesit, nga prodhimi apo importimi deri në përdorimin e fundit, gjatë gjithë jetëgjatësisë së lëndëve plasëse për përdorim civil, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

3. Ministria e Mbrojtjes merr të gjitha masat që ngritja dhe funksionimi i një sistemi të harmonizuar të gjurmimit dhe identifikimit të lëndëve plasëse për përdorim civil, në përputhje me aktet normative të Bashkimit Europian, të bëhet brenda datës 31 dhjetor 2012.

4. Rregullat dhe procedurat e krijimit të sistemit të gjurmimit dhe identifikimit miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. Ministria e Mbrojtjes kontrollon, verifikon, ndjek dhe zbaton sistemin e gjurmimit e të identifikimit dhe përcakton, me rregullore të veçantë, mënyrën, kushtet dhe kriteret.”.

Neni 10

Në nenin 12 pika 2, pas fjalëve “të nenit 5 pika 2” shtohen fjalët “nenit 7/1 pika 1”, ndërsa fjalët “nenit 10 pika 1” zëvendësohen me fjalët “nenit 10 pika 4”.

Neni 11

Dispozita të fundit

Çdo dispozitë tjetër, që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohet.

Neni 12

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6930, datë 18.3.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ

Nr.10 389, datë 3.3.2011

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.9668, DATË 18.12.2006 “PËR EMIGRIMIN E SHTETASVE SHQIPTARË PËR MOTIVE PUNËSIMI”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.9668, datë 18.12.2006 “Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 2 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 14 ndryshohet si më poshtë:

“14. “Emigrant i rikthyer” është shtetasi shqiptar i rikthyer në Republikën e Shqipërisë, për t'u larguar përsëri ose jo, pasi ka kaluar të paktën një vit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Të tillë janë edhe refugjatët e riatdhesuar, me dëshirë apo me detyrim, viktimat e trafikimit, fëmijët e pashoqëruar, të burgosurit e luftës, si dhe anëtarët e familjes së tyre. Emigrant i rikthyer është dhe shtetasi shqiptar i rikthyer me dëshirë apo detyrim nga vendet pritëse në Republikën e Shqipërisë, për shkak të mosplotësimit të dokumentacionit e të kushteve për hyrjen, praninë apo qëndrimin e rregullt në shtetet pritëse, në zbatim të marrëveshjeve të ripranimit, si dhe anëtarët e familjes së tyre.”.

2. Pika 16 ndryshohet si më poshtë:

“16. “Regjistri për emigrantët” është dokumenti zyrtar në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, i cili përmban një bazë të dhënash për shtetasit shqiptarë që dëshirojnë të emigrojnë e për shtetasit shqiptarë që janë kthyer nga emigrimi, të cilët janë objekt i këtij ligji.”.

3. Pas pikës 22 shtohet pika 23 me këtë përmbajtje:

“23. “Grupe vulnerabël” janë kategoria e emigrantëve më të prekshëm për t'u bërë objektiv i trafikimit.”.

Neni 2

Në nenin 8, pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Në zyrat përkatëse të punësimit ngrihen dhe funksionojnë sportelet e migracionit, të cilat ofrojnë shërbim informimi për shtetasit shqiptarë që dëshirojnë të emigrojnë, si dhe mbështetje për riintegrimin e emigrantëve të rikthyer.”.

Neni 3

Në nenin 9 pika 1, fjalët “që kanë fituar statusin e emigrantit të rikthyer në shtetin e origjinës” hiqen.

Neni 4

Në nenin 10, pika 2 shfuqizohet.

Neni 5

Neni 12 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 12

Regjistrimi i shtetasve

1. Çdo shtetas shqiptar, që kërkon të emigrojë për qëllime punësimi, si dhe shtetasit shqiptarë të rikthyer regjistrohen në “Regjistrin për emigrantët”, pranë sporteleve të migracionit në zyrat përkatëse të punësimit.

2. Regjistri qendror për emigrantët administrohet nga struktura përgjegjëse për çështjet e migracionit në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

3. Shtetasit shqiptarë të rikthyer, të regjistruar në “Regjistrin për emigrantët”, përfitojnë shërbim informimi dhe referimi në autoritetet shtetërore, përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve për riintegrim.

4. Forma, përmbajtja e regjistrit, dokumentacioni dhe procedurat e regjistrimit përcaktohen me urdhër të Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.”.

Neni 6

Neni 13 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 13

Përfitimi i statusit të emigrantit

1. Përfiton “Statusin e emigrantit” çdo emigrant i regjistruar në “Regjistrin për emigrantët” në zyrat e punësimit dhe që plotëson kushtet e parashikuara në këtë ligj për të përfituar “Dokumentin e statusit të emigrantit”.

2. Statusi i emigrantit krijon mundësinë që mbajtësi/titullari i këtij statusi të përfitojë nga kurset e formimit orientues, pa pagesë, për mësimin e gjuhës, ose të njohurive bazë për profesionet e kërkuara

nga shteti pritës, për shtetasit shqiptarë që dëshirojnë të emigrojnë dhe për pjesëtarët e familjes së tyre, si dhe nga programet e nxitjes së punësimit dhe kurset e formimit profesional publik falas, për emigrantët e rikthyer.

3. “Dokumenti i statusit të emigrantit” është dokument identifikues për mbajtësin/titullarin e tij edhe për përfitimin nga shërbimet e tjera specifike, si në fushën e strehimit, të shëndetësisë, të arsimit, të mbrojtjes shoqërore, të investimeve në vend etj.

Kriteret për përfitimin e këtyre shërbimeve nga titullari/mbajtësi i statusit të emigrantit përcaktohen me urdhër të ministrave përgjegjës, sipas fushave që ata mbulojnë.

4. “Dokumenti i statusit të emigrantit” është një dokument identifikimi dhe lëshohet nga zyra përkatëse e punësimit pranë njësisë së qeverisjes vendore.

5. Forma dhe përmbajtja e dokumentit, dokumentacioni përkatës dhe procedurat për përfitimin e statusit të emigrantit përcaktohen me urdhër të Ministrisë të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.”.

Neni 7

Neni 25 shfuqizohet.

Neni 8

Në nenin 28, pas shkronjës “d” shtohen shkronjat “dh”, “e”, “ë”, “f” dhe “g” me këtë përmbajtje:

“dh) harton dhe miraton programet aktive dhe pasive të punësimit e të formimit profesional në vend, për emigrantët e rikthyer, të cilët janë regjistruar si punëkërkues të papunë në zyrën përkatëse të punësimit;

e) bashkërendon procesin e informimit me autoritetet shtetërore përgjegjëse, sipas fushave përkatëse, si dhe informon për çështjet që i përkasin veprimtarisë së ministrisë, shtetasit shqiptarë që dëshirojnë të emigrojnë në mënyrë të rregullt, si dhe ata që rikthehen e dëshirojnë të riintegrohen e të qëndrojnë në Shqipëri;

ë) përgjigjet për bashkërendimin e punës për zbatimin e politikave në fushën e riintegrit të emigrantëve të rikthyer;

f) bashkërendon punën në procesin e negociatave dypalëshe dhe/ose shumëpalëshe, ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve të tjera, për nënshkrimin e marrëveshjeve ndërkombëtare në fushën e punësimit e të formimit profesional, në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme, sipas parashikimeve të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”;

g) në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror dhe njësitë e qeverisjes vendore, përgjigjet për sigurimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, si dhe për mbështetjen për plotësimin e kërkesës për përfitimin e ndihmës ekonomike, për emigrantët e rikthyer.”.

Neni 9

Në nenin 29 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Shkronja “c” shfuqizohet.

2. Shkronja “ç” ndryshohet si më poshtë:

“ç) mbledhjen në vendin pritës dhe shpërndarjen e informacionit për legjislacionin e punës dhe të mbrojtjes shoqërore, për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve emigrantë, bazuar në legjislacionin shqiptar, nëpërmjet pajisjes së përfaqësive diplomatike dhe konsullore me materiale publicistike, për publikimin e tyre në mjedise të dukshme, në formën e ekspozitave fotografike dhe temave, në interes të grupimeve të emigrantëve shqiptarë.”.

3. Shkronja “dh” riformulohet si më poshtë:

“dh) mbështetjen e shoqatave të emigrantëve shqiptarë dhe sigurimin e informacionit, nëpërmjet shoqatave e grupimeve të emigrantëve shqiptarë, për nevojat që ato kanë për hapjen e shkollave, për mësimin e gjuhës shqipe. Kjo mbështetje realizohet nëpërmjet bashkëpunimit me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, si dhe autoritetet shtetërore përgjegjëse të vendit pritës.”.

4. Pas shkronjës “ë” shtohen shkronjat “f”, “g” dhe “gj” me këtë përmbajtje:

“f) bashkërendimin e procesit të negociatave dypalëshe dhe/ose shumëpalëshe, ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve të tjera, për nënshkrimin e marrëveshjeve të ripranimit;

g) në bashkëpunim me strukturat e Ministrisë së Brendshme, është përgjegjëse për lëshimin e dokumenteve dhe të lejekalimeve të shtetasve shqiptarë, që kthehen përmes marrëveshjeve të ripranimit, si edhe për informimin për të drejtat dhe detyrimet e tyre;

gj) shpërndarjen e informacionit, për shërbimet që lehtësojnë riintegrimin e emigrantëve të rikthyer nëpër përfaqësitë e Republikës së Shqipërisë, të akredituara jashtë vendit.”.

Neni 10

Në nenin 30 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 1 bëhen ndryshimi dhe shtesat e mëposhtme:

a) Shkronja “c” ndryshohet si më poshtë:

“c) monitorimin nëpërmjet konsultimit elektronik të regjistrimit dhe kontrollit kufitar për emigrantët shqiptarë, në bashkëpunim me Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe me Ministrinë e Punëve të Jashtme.”.

b) Në fillim të shkronjës “ç” shtohen fjalët “mbledhjen dhe”.

c) Pas shkronjës “ç” shtohen shkronjat “d”, “dh” dhe “e” me këtë përmbajtje:

“d) informimin e emigrantëve të rikthyer në pikat e kalimit kufitar për shërbimet e riintegrimin në vend;

dh) lehtësimin e kthimit të emigrantëve të rikthyer, nëpërmjet krijimit të kushteve për transport të këtyerve nga pikat e kalimit kufitar deri në qendrat më të afërta të banimit;

e) sigurimin e nevojave me ushqim, ujë dhe medikamente, për grupet vulnerabël të emigrantëve të rikthyer në pikat e kalimit kufitar.”.

2. Pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Mënyra e konsultimit, regjistrimit dhe kontrollit kufitar për emigrantët shqiptarë, si dhe mbledhja e shkëmbimi i informacionit për numrin, shtetet dhe kohëzgjatjen e qëndrimit të emigrantëve shqiptarë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 11

Në nenin 31, pas shkronjës “d” shtohen shkronjat, “dh”, “e”, “ë”, “f”, “g” dhe “gj” me këtë përmbajtje:

“dh) hartimin e politikave dhe të legjislacionit, për lehtësimin e riintegrimin të fëmijëve të emigrantëve të rikthyer/fëmijëve të pashoqëruar në sistemin arsimor shqiptar pas kthimit, dhe njohjen e kualifikimeve të fituara jashtë;

e) hartimin e kurrikulave të veçanta, për mësimin plotësues të gjuhës shqipe nga emigrantët e rikthyer deri në moshën 18 vjeç ose 25 vjeç, nëse është duke ndjekur studimet e larta;

ë) organizimin e shkollave verore për fëmijët e emigrantëve të rikthyer/fëmijëve të pashoqëruar, për mësimin plotësues të gjuhës shqipe;

f) hartimin e programeve të veçanta në fushën e arsimit për t'u ardhur në ndihmë fëmijëve të emigrantëve të rikthyer/fëmijëve të pashoqëruar;

g) përshtatjen e politikave kurrikulare me nevojat e emigrantëve të rikthyer për arsimim;

gj) ofrimin e shërbimit psikologjik në sistemin arsimor ndaj fëmijëve të emigrantëve të rikthyer/fëmijëve të pashoqëruar dhe përshtatjen e tyre me shkollën, në marrëdhëniet ndërmjet komunitetit të nxënësve, si dhe në marrëdhëniet ndërmjet tyre dhe personelit mësimdhënës.”.

Neni 12

Pas nenit 31 shtohen nenet 31/1, 31/2, 31/3 dhe 31/4 me këtë përmbajtje:

“Neni 31/1

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, në zbatim të këtij ligji, ushtron detyrat e përgjegjësitë për:

a) sigurimin e ofrimit të informacionit të nevojshëm për emigrantët e rikthyer për programet sociale të strehimit;

b) hartimin e politikave dhe të legjislacionit për riintegrimin e emigrantëve të rikthyer të pastrehë, nëpërmjet përfshirjes së tyre në programet sociale të strehimit.

Neni 31/2

Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në zbatim të këtij ligji, ushtron detyrat e përgjegjësitë për:

a) zbatimin e politikave mbështetëse për emigrantët e rikthyer në Shqipëri, të cilët banojnë në zona rurale, sipas përcaktimeve me vendim të Këshillit të Ministrave;

b) përfshirjen e emigrantëve të rikthyer nga zonat rurale në programet për nxitjen e investimeve në sektorin e bujqësisë, sipas përcaktimeve me vendim të Këshillit të Ministrave;

c) sigurimin e ofrimit të informacionit të nevojshëm për emigrantët e rikthyer për skemat mbështetëse, sipas shkronjës “a” të këtij neni.

Neni 31/3

Ministria e Financave, në zbatim të këtij ligji, ushtron detyrat e përgjegjësitë për:

a) sigurimin e zbatimit të parashikimeve të Kodit Doganor, për përjashtime nga taksat doganore, për mjetet personale dhe veglat e punës për emigrantët e kthyer;

b) sigurimin e ofrimit të informacionit të nevojshëm, për emigrantët e rikthyer për skemat e sigurimeve shoqërore në Republikën e Shqipërisë.

Neni 31/4

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në zbatim të këtij ligji, ushtron detyrat e përgjegjësitë për:

a) informimin e emigrantëve të rikthyer për hapjen e një veprimtarie ekonomike në Shqipëri, si dhe për programe mbështetëse për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në Shqipëri;

b) krijimin e mundësive dhe dhënien e informacionit të nevojshëm për shtetasit shqiptarë investitorë, që jetojnë jashtë kufirit shqiptar, të investojnë në vend në fushat me përparësi për vendin.”.

Neni 13

Në nenin 32 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Në shkronjën “a” të pikës 1, fjalët “shtetasit emigrantë” zëvendësohen me fjalët “emigrantët dhe emigrantët e rikthyer”.

2. Në pikën 2, pas emërimit “Ministrit të Financave” shtohen emërtimet “Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministrit të Shëndetësisë.”.

Neni 14

Në nenin 33, pas emërimit “Ministria e Arsimit dhe Shkencës” shtohen emërtimet “Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.”.

Neni 15

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6931, datë 18.3.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ
Nr.10 390, datë 3.3.2011

PËR PLEHRAT E PËRDORIMIT PËR BIMËSINË*

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim:

1. Vlerësimin e plehrave.
2. Përcaktimin e tipave të plehrave, që përdoren në Republikën e Shqipërisë.
3. Kontrollin e prodhimit, të paketimit, të etiketimit, të transportit, të magazinimit dhe të vendosjes në treg të plehrave.
4. Përcaktimin e detyrimit për regjistrimin e plehrave që nuk kanë emërtimin “EC Fertilizers”.
5. Organizimin dhe funksionimin e strukturave përgjegjëse.

Neni 2
Objektivat

Objektivat e këtij ligji janë:

1. Të mbështesë rritjen e prodhimit në bujqësi.
2. Të mundësojë drejtimin e kontrollin e prodhimit dhe vendosjen në treg të plehrave.
3. Të ndihmojë në ruajtjen e jetës dhe të shëndetit të njerëzve e të kafshëve dhe në mbrojtjen e konsumatorit.
4. Të ndihmojë ruajtjen e tokës dhe mbrojtjen e mjedisit.

Neni 3
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Pleh” është çdo substancë që përmban elemente ushqyese, funksioni kryesor i së cilës është sigurimi i ushqimit për bimët.
2. “Tipat e plehrave” janë plehrat që i përkasin grupimeve kryesore të plehrave, si minerale, organike, organo-minerale dhe nënndarjeve të çdo grupi.
3. “Pleh i thjeshtë” është plehu azotik, fosfatik ose potasik, që kanë në përbajtjen e tyre të njohur vetëm njërin prej lëndëve ushqyese parësore.
4. “Pleh i përzier” është plehu që sigurohet nga përzierja e thatë e plehrave të ndryshme, pa shkaktuar reaksione kimike.

* 32003 R 2003 (Celex No). Rregullore e Bashkimit Europian 2003/2003 i Parlamentit dhe Këshillit Europian, datë 13 tetor 2003 në lidhje me plehrat. Gazeta zyrtare nr.304, datë 21.11.2003, faqe 0001-0194.

5. “Plehra të papërshtatshme” janë plehurat, që në përbërjen e tyre kanë elemente kimike jashtë standardeve të miratuara dhe përbëjnë rrezik për sigurinë apo shëndetin e njerëzve, të kafshëve e të bimëve, si dhe rrezikojnë mjedisin.

6. “Pleh me emërtimin “EC Fertilizers”” është plehu i listuar sipas pikës 1 të nenit 9 të këtij ligji dhe që plotëson kërkesat e këtij ligji.

7. “Lëndë ushqyese parësore” janë vetëm elementet azot, fosfor dhe potas.

8. “Lëndë ushqyese dytësore” janë vetëm elementet kalcium, magnez, natrium dhe squfur.

9. “Tolerancë” janë shmangiet e lejuara të vlerave të matura të përmbajtjes së ushqyesve nga vlera e deklaruar e tyre.

10. “Prodhues” është personi fizik ose juridik, vendas apo i huaj, përgjegjës për vendosjen në treg të plehrave; në veçanti një prodhues, një importues, një paketues që punon për llogari të vet apo çdo person që ndryshon karakteristikat e një plehu.

11. “Laborator reference” është laboratorit që vlerëson cilësinë dhe besueshmërinë e kryerjes së analizave laboratorike për plehurat nga laboratorët e miratuar, si dhe kryen analizat për regjistrimin e plehrave, sipas metodave dhe standardeve, të përcaktuara në këtë ligj.

12. “Vendosje në treg” është importimi, importimi i plehurat brenda territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, eksportimi, tregtimi dhe magazinimi i plehrave në territorin e Republikës së Shqipërisë.

13. “Inspektor” është inspektori i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (AKU), që kontrollon zbatimin e këtij ligji.

14. “Komision” është komisioni i vlerësimit dhe regjistrimit të plehrave.

15. “Vlerësim i plehrave” është gjykimi për përshtatshmërinë dhe dobishmërinë e futjes së një plehu të ri në tregun vendas.

16. “Certifikatë regjistrimi” është dokumenti zyrtar, i lëshuar nga komisioni, që vërteton regjistrimin e tipave të caktuar të plehrave në regjistrin përkatës.

17. “Regjistri i plehrave” është dokumenti, ku regjistrohen të gjitha tipat e plehrave, që prodhohen e vendosen në treg në Republikën e Shqipërisë, të vlerësuara nga komisioni.

18. “Tjetërsim” është çdo ndryshim i treguesit të plehurat nga ai i deklaruar në etiketë, paketim ose në certifikatën shoqëruese të analizave.

19. “Mostër” është një sasi plehu, që përbën një njësi, me karakteristika përfaqësuese uniforme.

20. “Etiketë” është pamja ose modeli i shkruar, i vënë mbi paketim ose i bashkëlidhur në të, ku përshkruhen karakteristikat kryesore të plehurat.

21. “Dokumentacion” është dokumentacioni shoqërues i plehrave, nxjerrë nga shoqëria prodhuese.

22. “Parti malli” është sasia e një kategorie plehu, e identifikueshme për origjinën dhe homogjenitetin e saj, në lidhje me përbërjen dhe cilësinë.

23. “Prodhim” është procesi i sigurimit të plehrave, ku përfshihen edhe përzierja e ripaketimi.

24. “Paketim” është një material i mbyllur, i përdorur për të mbajtur, për të mbrojtur, për të mirëmbajtur e për të shpërndarë plehurat dhe që mban brenda një sasi jo më shumë se 1000 kg.

25. “Pleh i hapur” është plehu i papaketuar, sipas përcaktimit të dhënë në pikën 24 të këtij neni.

26. “Mikroushqyes” është bor, kobalt, bakër, hekur, mangan, molibden dhe zink, të cilat janë thelbësore për rritjen e bimëve, por në sasi të pakta në krahasim me ato të elementeve ushqyese parësore dhe dytësore.

27. “Pleh inorganik” është plehu, me elementet ushqyese të deklaruara, të cilat janë në formë minerale, që merren nga ekstraktimi ose nëpërmjet proceseve industriale fizike dhe/ose kimike.

28. “Pleh i përbërë” është plehu që ka një përmbajtje të deklaruar e të paktën dy prej elementeve ushqyese parësore dhe të marra në rrugë kimike ose nga përzierja apo një kombinim i të dyjave.

29. “Pleh kompleks” është plehu i përbërë, i marrë në rrugë kimike nga tretësira ose gjendja e ngurtë, nga granulimi, që ka një përmbajtje të deklaruar e të paktën dy prej elementeve ushqyese parësore. Në gjendje të ngurtë çdo grimcë përmban të gjitha elementet ushqyese përbërëse të tyre të deklaruara.

30. “Pleh për plehërim gjethor” është plehu i përcaktuar për t’u përdorur mbi masën e gjetheve të bimëve me synim thithjen e lëndëve ushqyese prej tyre.

31. "Pleh i lëngshëm" është plehu në formë tretësire.
32. "Deklarim" është deklarata për sasinë e lëndëve ushqyese, që përfshin formën dhe tretshmërinë e tyre, të garantuar me anë të tolerancave të specifikuara.
33. "Përmbajtje e deklaruar" është përmbajtja e një elementi ose e formave të tij, e cila jepet në etiketën e një plehu apo në dokumentin shoqërues përkatës.

KREU II
PRODHIMI, QARKULLIMI I LIRË, VENDOSJA NË TREG, MAGAZINIMI, TRANSPORTI,
PAKETIMI, ETIKETIMI DHE CERTIFIKATA E ANALIZËS DHE E ORIGJINËS

Neni 4

Prodhimi, qarkullimi i lirë dhe vendosja në treg

1. Prodhimi dhe/ose vendosja në treg e plehrave bëhet nga persona fizikë dhe juridikë, vendas ose të huaj.
2. Plehrat vendosen në treg vetëm në qoftë se:
 - a) janë plehra me emërtimin "EC Fertilizers", të cilat lejohen të qarkullojnë lirshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë;
 - b) janë plehra që nuk kanë emërtimin "EC Fertilizers", por janë të pajisura me certifikatë regjistrimi, sipas dispozitave të këtij ligji;
 - c) nuk dëmtojnë shëndetin e njerëzve, të kafshëve, pjellorinë e tokës dhe mjedisin;
 - ç) përmbushin të gjitha kërkesat për etiketimin, paketimin dhe magazinimin, sipas dispozitave të këtij ligji;
 - d) përmbushin tolerancat, sipas dispozitave të këtij ligji;
 - dh) nuk janë të zhvleftësuar.

Neni 5

Transporti, magazinimi dhe mirëmbajtja

1. Transporti i plehrave bëhet me çdo lloj mjeti, të pajisur me karroceri të rregullt, të mbuluar tërësisht, poshtë dhe lart, me plastmasë ose mushama, si masë mbrojtjeje, në çdo rast, nga kontakti me lagështirën dhe nga rrjedhjet gjatë udhëtimit.
2. Të gjitha llojet e plehrave, pas prodhimit apo sjelljes nga importi, depozitohen dhe ruhen në mjedise të mbyllura, të mbrojtura nga lagështira, dyshemeja e të cilave duhet të jetë e shtruar me paleta druri. Në këto mjedise nuk duhet të ketë mallra të tjera. Mjediset për magazinimin dhe tregtimin e plehrave duhet të jenë të miratuara nga inspektorati sanitar shtetëror i rrethit ose qarkut.
3. Plehrat gjatë magazinimit duhet:
 - a) të jenë të ndara nga njëra-tjetra;
 - b) të jenë të shënuara në mënyrë të qartë;
 - c) të mos jenë të përziera me substanca të tjera.
4. Plehrat duhet të magazinohen në mënyrë të tillë që të mos rrisin nivelin e ndotjes së ujërave. Elementet ose substancat e rrezikshme, të cilat mund të dëmtojnë zhvillimin e kulturave bujqësore apo të zinxhirit ushqimor, nuk duhet të vendosen në të njëjtin vend me plehrat.

Neni 6

Paketimi, etiketimi, certifikata e analizës dhe e origjinës

1. Plehrat mund të vendosen në treg, të hapura ose të paketuara. Paketimet duhet të jenë të tilla që të ruajnë karakteristikat fizike dhe kimike të plehut. Në rastin e plehrave të paketuara, paketimi duhet të jetë i mbyllur në një mënyrë ose me një mjet të tillë që, në qoftë se hapet, mbyllja ose vetë paketimi dëmtohet në mënyrë të pandreqshme. Etiketa ose shënimet janë të stampuara në paketim dhe tregojnë tipin e përbërjen e plehut. Çdo parti malli e plehut shoqërohet me certifikatën e analizës e të origjinës, me anë të së cilës prodhuesi deklaron treguesit e nevojshëm teknikë të atij plehu.
2. Prodhuesi, që vendos plehrat në treg, është i detyruar që, në etiketë, të përcaktojë:
 - a) emrin dhe adresën e biznesit;

b) emrin e plehut dhe numrin e certifikatës së regjistrimit, nëse plehu korrespondon me tipin e plehrave;

c) përmbajtjen e përbërësve të çdo plehu, përfshirë edhe përmbajtjen e elementeve të përshkruara me fjalë dhe simbole kimike, si: azot (N), fosfor (P), pentoksid fosfori (P₂O₅), potas (K), oksid potasi (K₂O), kalcium (Ca), oksid kalciumi (CaO), magnez (Mg), oksid magnezi (MgO), natrium (Na), oksid natriumi (Na₂O), squfur (S), trioksid squfuri (SO₃), bor (B), bakër (Cu), kobalt (Co), hekur (Fe), mangan (Mn), molibden (Mo), zink (Zn) dhe në lidhje me ushqyesit e format e tretshme;

ç) kërkesat specifike në magazinim dhe përdorim;

d) paralajmërimin dhe informacionin për manipulimin dhe udhëzimet për mbrojtjen e shëndetit të njerëzve, sigurinë e mbrojtjen e mjedisit;

dh) metodën e përdorimit;

e) masën ose vëllimin e përgjithshëm të plehut;

ë) afatin e përdorimit;

f) datën e prodhimit.

3. Informacioni për plehun, i përcaktuar në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, duhet të jetë në gjuhën shqipe dhe qartësisht i lexueshëm gjatë të gjithë kohës.

4. Për plehrat e hapura, etiketimi specifik duhet të jetë i përcaktuar në dokumentet shoqëruese të plehut.

Neni 7

Plehra të papërshtatshme

1. Kur të dhënat e specifikuar në certifikatën e analizës dhe të origjinës për një pleh nuk përputhen me ato të dala nga laboratorit për analizimin e plehrave, ky pleh konsiderohet i papërshtatshëm dhe bllokohet, kthehet në vendin e origjinës, asgjësohet ose përmirësohet në përputhje me treguesit.

2. Lloji i masës që merret, mënyra dhe procedurat e bllokimit, të kthimit në vendin e origjinës, të asgjësimit ose të përmirësimit në përputhje me treguesit për plehrat e papërshtatshme, përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit, që mbulon fushën e bujqësisë, të ministrit që mbulon fushën e shëndetësisë dhe të ministrit që mbulon fushën e mjedisit.

3. Të gjitha shpenzimet për bllokimin e plehrave, kthimin e tyre në vendin e origjinës, asgjësimin apo përmirësimin, në përputhje me treguesit, i ngarkohen prodhuesit.

Neni 8

Plehrat e nitratit të amonit, me përmbajtje të lartë azoti

1. Plehrat me bazë nitrat amoni, me përmbajtje të lartë azoti, janë produkte me bazë nitrat amoni, të prodhuara për t'u përdorur si plehra dhe që përmbajnë mbi 28 për qind në masë të azotit në raport me nitratin e amonit. Ky tip plehu mund të përmbajë substanca inorganike ose inerte. Substancat, që janë përdorur në prodhimin e këtij tipi plehu, nuk duhet të rrisin ndjeshmërinë e tij ndaj nxehtësisë dhe ndaj shpërthimit.

2. Prodhuesi duhet të sigurojë që plehrat e thjeshta me bazë nitrati të amonit, me përmbajtje të lartë të azotit, duhet të plotësojnë kërkesat e këtij ligji.

3. Kontrolli, analizat dhe testimet zyrtare të plehrave të thjeshta me bazë të nitratit të amonit, me përmbajtje të lartë të azotit, duhet të jenë në përputhje të plotë me metodat e përcaktuara në këtë ligj.

4. Për të siguruar kontrollin e plehrave me bazë nitrat amoni, me përmbajtje të lartë të azotit, të vendosura në treg, prodhuesi mban një regjistër të veçantë vetëm për këtë lloj plehu, ku përcaktohen emri, adresa dhe vendndodhja e prodhuesit, si dhe e përdoruesve të këtij plehu. Ky regjistër duhet të jetë i disponueshëm për inspektimet që kryhen për të gjithë periudhën e vendosjes në treg të këtij plehu.

5. Prodhuesi duhet të sigurojë që çdo tip i plehrave me bazë nitrat amoni, me përmbajtje të lartë të azotit, që vendoset në treg, të ketë kaluar testin e rezistencës ndaj shpërthimit. Ky test duhet të jetë bërë në laboratorë të akredituar, që plotësojnë kërkesat e standardeve S SH EN 17025, S SH EN 45003 apo të standardeve të njëvlershme me to dhe i shoqëruar me certifikatën origjinale të rezistencës ndaj shpërthimit. Kalimi i testit të shpërthyeshmërisë është kusht i domosdoshëm për të gjitha plehrat që vendosen në treg.

6. Për plehrat me emërtimin “EC Fertilizers” të nitratit të amonit, me përmbajtje të lartë të azotit, testi i rezistencës ndaj shpërthimit kryhet nga laboratorë të miratuar të Bashkimit Europian. Prodhuesi duhet të dorëzojë rezultatet e këtij testi pranë AKU-së 5 ditë përpara arritjes së këtij plehu në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

7. Plehrat e nitratit të amonit, me përmbajtje të lartë të azotit, duhet të jenë të disponueshme përpara përdorimit përfundimtar vetëm në formë të paketuara.

8. Kërkesat e hollësishme për plehrat me bazë nitrat amoni, me përmbajtje mbi 28 për qind azot, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit që mbulon fushën e bujqësisë.

Neni 9

Kërkesat dhe kushtet për trajtimin e plehrave

1. Rregullat për kërkesat e prodhimit, të etiketimit e të paketimit për vendosjen në treg, si dhe tolerancat, lista e tipave të plehrave me emërtimin “EC Fertilizers” përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit që mbulon fushën e bujqësisë.

2. Kushtet për transportimin, magazinimin dhe mirëmbajtjen e plehrave përcaktohen me udhëzim të ministrit që mbulon fushën e bujqësisë.

Neni 10

Detyrimet e prodhuesit

1. Prodhuesi, që merret me prodhimin dhe/ose vendosjen në treg të plehrave, është i detyruar që, për kryerjen e kontrollit dhe shqyrtimin e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm, të bashkëpunojë me inspektorët.

2. Asnjë prodhues nuk mund të refuzojë apo të pengojë inspektorin për të kryer detyrat e përcaktuara në këtë ligj.

KREU III

MËNYRA E ORGANIZIMIT DHE E FUNKSIONIMIT TË STRUKTURAVE PËRGJEGJËSE

Neni 11

Strukturat përgjegjëse

Strukturat përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij janë:

1. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.
2. Komisioni.
3. Laboratorët e akredituar.

Neni 12

Organizimi dhe detyrat e inspektorit

1. Inspektori është pjesë e strukturës dhe organikës së AKU-së.
2. Inspektori kryen këto detyra:
 - a) inspekton tipat e plehrave, që prodhohen dhe vendosen në treg;
 - b) kontrollon të dhënat e përshkruara në etiketë dhe paketim, nëse janë në përputhje me të dhënat e dokumentacionit që shoqëron plehun;
 - c) merr mostrat e plehut dhe i dërgon ato për analizim në laboratorin e akredituar;
 - ç) kontrollon mirëmbajtjen e plehrave, sipas kushteve të përcaktuara në këtë ligj;
 - d) nuk lejon përdorimin e plehrave për qëllime të tjera, që nuk janë parashikuar në këtë ligj;
 - dh) merr masa administrative për shkeljet dhe parregullsitë, që dalin gjatë kryerjes së kontrollit, kur vëren shkelje të kushteve për prodhimin e vendosjen në treg të plehrave.

Neni 13
Ndihma ndërinstitucionale

AKU-ja, për zbatimin e detyrave të ngarkuara me këtë ligj, bashkëpunon sipas marrëveshjeve të nënshkruara me Policinë e Shtetit, strukturat përgjegjëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Neni 14
Komisioni i vlerësimit dhe regjistrimit të plehrave

1. Për vlerësimin dhe regjistrimin e plehrave, që nuk kanë emërtimin “EC Fertilizers”, ngrihet dhe funksionon, në ministrinë që mbulon fushën e bujqësisë, komisioni i përbërë nga 9 anëtarë.

2. Përbërja, funksionimi, detyrat e këtij komisioni, si dhe procedurat e hollësishme për regjistrimin dhe vlerësimin e plehrave përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit që mbulon fushën e bujqësisë.

Neni 15
Regjistrimi i plehrave

1. Komisioni vendos për regjistrimin e plehrave në bazë të kërkesës së prodhuesit.
2. Kërkesa për regjistrim përmban:
 - a) të dhëna identifikuese të prodhuesit;
 - b) vendndodhjen e biznesit të tij;
 - c) emrin e plehut dhe tipin e tij;
 - ç) përmbajtjen e çdo përbërësi të plehut, përfshirë edhe përmbajtjen e elementeve e të substancave toksike në lidhje edhe me format e ushqyesve dhe format e tretshme;
 - d) dendësinë e plehut;
 - dh) metodën e përdorimit të plehut sipas kulturave bujqësore;
 - e) kushtet e magazinimit të tij;
 - ë) përshkrimin e teknikave, përfshirë edhe listën e materialeve të përdorura për prodhimin e plehut;
 - f) konfirmimin që nuk është një pleh eksploziv, megjithëse nitrati i amonit përmban mbi 28 për qind azot, sipas përcaktimit të pikës 1 të nenit 8 të këtij ligji.
3. Prodhuesi paraqet kërkesën për regjistrim dhe i garanton komisionit mostrat e plehut dhe dokumentacionin e nevojshëm, që vërteton përmbushjen e kërkesave për regjistrim. Në të njëjtën kohë prodhuesi paguan tarifën përkatëse.
4. Kur komisioni gjykon për nevojën e verifikimit të vlefshmërisë së një plehu, vendos për testimin fushor të tij.
5. Komisioni, në bazë të kërkesës dhe të të dhënave të listuara në të, jo më vonë se 3 muaj, vendos për dhënien ose jo të certifikatës së regjistrimit të plehut.
6. Shpenzimet për ekspertimin, në lidhje me procedurat e regjistrimit, paguhen nga prodhuesi.
7. Të gjitha plehurat e miratuara nga komisioni regjistrohen në regjistrin e plehrave, i cili mbahet nga inspektori. Forma dhe përmbajtja e regjistrit përcaktohen me urdhër të ministrit që mbulon fushën e bujqësisë.
8. Tarifat, që paguhen nga prodhuesi për marrjen e certifikatës së regjistrimit dhe për regjistrimin e plehrave që prodhohen dhe/ose vendosen në treg, përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit që mbulon fushën e bujqësisë dhe të ministrit që mbulon fushën e financave.

Neni 16
Certifikata e regjistrimit

1. Certifikata e regjistrimit të plehut, që i jepet prodhuesit, lëshohet nga komisioni.
2. Vendimi për regjistrimin përmban:
 - a) emrin e plehut;

- b) numrin e vendimit të regjistrimit;
- c) vlerat e përbërësve kimikë dhe fizikë të plehut;
- ç) metodën e përdorimit të plehut sipas kulturave bujqësore;
- d) afatin e vlefshmërisë së tij.

3. Në rastet e ndryshimit të emrit të plehut e të të dhënave identifikuese të prodhuesit, për të cilin është dhënë vendimi për regjistrimin e plehut, prodhuesi paraqet një kërkesë për ndryshimin e vendimit të regjistrimit. Komisioni vendos për regjistrimin e ri.

4. Komisioni anulon vendimin e regjistrimit të plehrave:

- a) me kërkesë të prodhuesit;
- b) në rastet kur prodhuesi shkel njërën nga kërkesat e këtij ligji.

5. Komisioni, me kërkesë të inspektorit, kur e gjykon të arsyeshme, mund të urdhërojë largimin nga tregu të sasisë së plehut.

Neni 17 **Laboratorët**

1. Kryerja e analizave laboratorike për plehrat bëhet nga laboratorë të akredituar, që janë miratuar, për këtë qëllim, nga ministri që mbulon fushën e bujqësisë. Analizat për regjistrimin e plehrave bëhen nga një laborator i akredituar, i miratuar si laborator reference nga ministri që mbulon fushën e bujqësisë.

2. Laboratori i referencës dhe laboratorët e akredituar kanë për detyrë:

- a) kryerjen e analizave të mostrave të marra për efekt të verifikimit dhe vlerësimit të përbërësve të plehrave;
- b) lëshimin e fletës së analizave për rezultatet përfundimtare, që dalin nga analizimi i çdo mostre;
- c) respektimin dhe garantimin e të gjitha shërbimeve të nevojshme për verifikimin e përputhshmërisë së plehrave me kërkesat e këtij ligji.

3. Përveç sa përcaktohet në pikën 2 të këtij neni, laboratori i referencës vlerëson cilësinë dhe besueshmërinë e kryerjes së analizave laboratorike për plehrat nga laboratorët e miratuar.

4. Ministri që mbulon fushën e bujqësisë miraton kriteret që duhet të plotësojnë laboratorit i referencës dhe laboratorët e akredituar për t'u miratuar.

Neni 18 **Veprimtari të ndaluara**

Nuk lejohen:

1. Prodhimi dhe vendosja në treg e plehrave me përmbajtje substancash toksike, të përcaktuara si të tilla nga komisioni.

2. Prodhimi, regjistrimi dhe vendosja në treg e plehrave të tjetërsuara, për përdorim për bimësinë, të dhënat e të cilave nuk përputhen me të dhënat e certifikatës së analizave dhe të certifikatës së origjinës.

Neni 19 **Ankimi**

1. Kur prodhuesi nuk është dakord me vendimin e marrë nga komisioni për certifikatën e regjistrimit, mund të bëjë ankim, me shkrim, te ministri që mbulon fushën e bujqësisë, brenda 30 ditëve nga data e shpalljes ose e marrjes së njoftimit të vendimit.

2. Ministri që mbulon fushën e bujqësisë shprehet me vendim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së ankimit. Ky është vendim përfundimtar administrativ. Kundër vendimit përfundimtar administrativ prodhuesi mund të bëjë ankim në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e shpalljes ose e marrjes së njoftimit të vendimit.

KREU IV
KONTROLI, MARRJA E MOSTRAVE, ANALIZIMI
DHE VLERËSIMI I PLEHRAVE

Neni 20
Kontrolli dhe marrja e mostrave

1. Kontrolli dhe marrja e mostrave për analizim të plehut bëhen nga inspektorët e AKU-së.
2. Inspektorët, gjatë ushtrimit të detyrave të tyre, duhet të identifikohen me dokument zyrtar, të lëshuar nga organi i përcaktuar me ligj.
3. Dokumenti i identifikimit lëshohet nga ministri që mbulon fushën e bujqësisë.

Neni 21
Analizat

1. Analizat laboratorike të mostrave të plehrave bëhen në laboratorin e referencës dhe në laboratorët e tjerë të akredituar, sipas metodave dhe standardeve të përcaktuara në nenin 22 të këtij ligji. Rezultati përfundimtar i analizave i dorëzohet inspektorit brenda një periudhe kohe prej 10 ditësh nga çasti i dorëzimit të mostrës për analizim.
2. Vlerësimi i rezultateve të analizave zyrtare të mostrave bëhet nga inspektori.

Neni 22
Rregullat për marrjen e mostrave, analizimin dhe vlerësimin

Rregullat për kontrollin, marrjen e mostrave, analizat e procedurat, dhënia e rezultateve të tyre, si dhe vlerësimi i analizave të plehrave përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit që mbulon fushën e bujqësisë.

KREU V
KUNDËRVAJTJE ADMINISTRATIVE

Neni 23
Kundërvajtje administrative

Përbëjnë kundërvajtje administrative shkeljet e mëposhtme:

1. Moszbatimi nga personat fizikë dhe juridikë, vendas apo të huaj, të kërkesave të përcaktuara në pikën 2 të nenit 4 të këtij ligji.
2. Mosrespektimi në shitje i të dhënave të pikës 2 shkronja “e” të nenit 6 të këtij ligji.
3. Moszbatimi nga personat fizikë dhe juridikë, vendas apo të huaj, të kërkesave të përcaktuara në pikën 1 të nenit 7 të këtij ligji.
4. Moszbatimi nga personat fizikë dhe juridikë, vendas apo të huaj, të kërkesave të nenit 10 të këtij ligji.
5. Moszbatimi nga personat fizikë dhe juridikë, vendas apo të huaj, të kërkesave të përcaktuara në pikën 1 të nenit 18 të këtij ligji.
6. Moszbatimi nga personat fizikë dhe juridikë, vendas apo të huaj, të kërkesave të përcaktuara në pikën 2 të nenit 18 të këtij ligji.

Neni 24
Sanksionet

1. Për kundërvajtjet e mëposhtme administrative, inspektori jep dënim me gjobë, përkatësisht, për:
- a) ato të parashikuara në pikën 1 të nenit 23 të këtij ligji, nga 40 mijë deri në 60 mijë lekë;

- b) ato të parashikuara në pikën 2 të nenit 23 të këtij ligji, me 40 mijë lekë;
 - c) ato të parashikuara në pikën 3 të nenit 23 të këtij ligji, me 200 mijë lekë;
 - ç) ato të parashikuara në pikën 4 të nenit 23 të këtij ligji, nga 80 mijë deri në 120 mijë lekë;
 - d) ato të parashikuara në pikën 5 të nenit 23 të këtij ligji, nga 80 mijë deri në 120 mijë lekë dhe detyron subjektin ta kthejë plehun në vendin e origjinës;
 - dh) ato të parashikuara në pikën 6 të nenit 23 të këtij ligji, nga 180 mijë deri në 220 mijë lekë.
2. Në rast të përsëritjes së këtyre shkeljeve, masa e gjobës është trefish.

Neni 25

Procedura e kundërvajtjes administrative

1. Të drejtën e dhënies së masës administrative, siç është parashikuar në nenin 24 të këtij ligji, e ka inspektori.
2. Kundër vendimit të inspektorit mund të bëhet ankim me shkrim te Drejtori i Përgjithshëm i AKU-së brenda 10 ditëve nga data e shpalljes ose e marrjes së vendimit. Drejtori duhet t'i përgjigjet ankimit brenda 10 ditëve nga data e paraqitjes së tij.
3. Kundër vendimit të Drejtorit të Përgjithshëm të AKU-së, ose kur ai nuk përgjigjet sipas afateve të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, mund të bëhet ankim në gjykatën e rrethit gjyqësor, ku është kryer kundërvajtja, brenda 30 ditëve nga data e shpalljes ose e marrjes së njoftimit të vendimit.

Neni 26

Ekzekutimi i vendimit

Ekzekutimi i vendimit bëhet sipas procedurave të përcaktuara në ligjin nr.10 279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative".

Neni 27

Të ardhurat nga vjelja e gjobave

Të ardhurat, që krijohen nga vjelja e gjobave, kalojnë 100 për qind në Buxhetin e Shtetit.

KREU VI

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 28

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 8 pika 8, 9 pika 1, 14 pika 2 dhe 22 të këtij ligji.
2. Ngarkohet ministri që mbulon fushën e bujqësisë të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 9 pika 2, 15 pika 7 dhe 17 pika 4 të këtij ligji.
3. Ngarkohen ministri që mbulon fushën e bujqësisë dhe ministri që mbulon fushën e financave të nxjerrin aktin nënligjor në zbatim të pikës 8 të nenit 15 të këtij ligji.
4. Ngarkohen ministri që mbulon fushën e bujqësisë, ministri që mbulon fushën e shëndetësisë dhe ministri që mbulon fushën e mjedisit të nxjerrin aktin nënligjor në zbatim të pikës 2 të nenit 7 të këtij ligji.
5. Afati i nxjerrjes së akteve nënligjore, të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, është 6 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji për nenin 14 pika 2 dhe 12 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji për nenin 8 pika 8, nenin 9 pika 1 dhe nenin 22. Afati i nxjerrjes së akteve nënligjore, të përcaktuara në pikat 2, 3 dhe 4 të këtij neni, është 12 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 29

Dispozita kalimtare

1. Laboratorëve shtetërorë u lihet një periudhë 3-vjeçare nga data e hyrjes në fuqi e këtij ligji, për marrjen e certifikatës së akreditimit. Deri në marrjen e kësaj certifikate ato vazhdojnë të kryejnë shërbimet e parashikuara në këtë ligj.

2. Deri në plotësimin e afatit të përcaktuar në pikën 5 të nenit 28 të këtij ligji, mbeten në fuqi aktet nënligjore, të dala në zbatim të ligjit nr.8531, datë 23.9.1999 “Për shërbimin e kontrollit të plehrave kimike”, për sa ato janë në pajtueshmëri dhe nuk bien në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji.

Neni 30
Shfuqizimet

Ligji nr.8531, datë 23.9.1999 “Për shërbimin e kontrollit të plehrave kimike”, shfuqizohet.

Neni 31
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6932, datë 18.3.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ
Nr.10 391, datë 3.3.2011

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9917, DATË 19.5.2008 “PËR
PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE DHE FINANCIMIT TË TERRORIZMIT”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 2 bëhen ndryshimet dhe shtesa si më poshtë:

1. Pika 10 ndryshohet si më poshtë:

“10. “Personat e ekspozuar politikisht” janë personat, të cilët janë të detyruar të bëjnë deklarin e pasurive të tyre, në përputhje me ligjin nr.9049, datë 10.4.2003 “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, me përjashtim të nëpunësve të nivelit të mesëm apo të ulët drejtues, sipas përcaktimeve të legjislacionit për shërbimin civil. Në këtë kategori përfshihen edhe individët, të cilët kanë pasur ose kanë funksione të rëndësishme në një qeveri dhe/ose në një shtet të huaj, si: kryetar shteti dhe/ose qeverie, politikanë të lartë, zyrtarë të lartë të qeverisë, të gjykatave ose të ushtrisë, drejtues të lartë të kompanive shtetërore, zyrtarë të rëndësishëm të partive politike.”.

2. Në pikën 12 shkronjat “a” dhe “b”, fjalët “shumicën e” zëvendësohen me fjalët “të paktën 25 për qind të”.

3. Pas pikës 21 shtohet pika 22 me këtë përmbajtje:

“22. “Person”, në kuptim të këtij ligji, konsiderohen individët, personat fizikë tregtarë dhe personat juridikë.”.

Neni 2

Në nenin 3 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Shkronja “a” ndryshohet si më poshtë:

“a) subjektet bankare, si dhe çdo subjekt tjetër që licencohet apo mbikëqyret nga Banka e Shqipërisë, duke përfshirë, por pa u kufizuar në subjektet e parashikuara në shkronjat “b”, “c” e “ç” të këtij neni.”.

2. Në shkronjën “b” fjalët “institucionet financiare jobanka” zëvendësohen me fjalët “subjektet financiare jobanka”.

3. Shkronja “dh” shfuqizohet.

4. Në shkronjën “gj”, pas fjalëve “përfaqësues të tjerë ligjorë” shtohen fjalët “profesionet e rregulluara, që ofrojnë shërbimet e konsulencës financiare”.

5. Shkronja “h” ndryshohet si më poshtë:

“h) agentët e pasurive të paluajtshme, sipas kuptimit të përcaktuar në legjislacionin shqiptar për këtë kategori, kur përfshihen në transaksione për klientët e tyre, që lidhen me blerje ose shitje të pasurive të paluajtshme.”.

6. Nënndarjet “ii”, “v” dhe “ix” të shkronjës “k” shfuqizohen.

Neni 3

Në nenin 4 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në shkronjën “b” të pikës 1, pas fjalëve “një transfertë të drejtpërdrejtë brenda ose jashtë vendit” shtohen fjalët “në një shumë të barabartë ose më të madhe se 100 000 (njëqind mijë) lekë ose kundërvlerën e saj në monedha të huaja.”.

2. Nënndarja “i” e shkronjës “b” të pikës 1 ndryshohet si më poshtë:

“i) jo më pak se 200 000 (dyqind mijë) lekë ose kundërvlerën e saj në monedha të huaja për subjektet e përcaktuara në shkronjat “c” dhe “g” të nenit 3 të këtij ligji.”.

3. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Subjektet duhet të identifikojnë dhe të verifikojnë identitetin e pronarit përfitues.”.

Neni 4

Në nenin 8 bëhen këto ndryshime:

1. Pikat 1 dhe 2 ndryshohen si më poshtë:

“1. Subjektet e përcaktuara në shkronjën “a” të nenit 3 të këtij ligji, përveç procedurave të vigjilencës së zgjeruar ndaj klientit, duhet:

a) të hartojnë dhe të zbatojnë sisteme efektive të menaxhimit të riskut për të përcaktuar nëse një klient ekzistues apo potencial ose pronari përfitues është një person i ekspozuar politikisht;

b) të marrin miratimin e drejtuesve të lartë për vendosjen e marrëdhënieve të biznesit me personat e ekspozuar politikisht;

c) të kërkojnë dhe të marrin miratimin e drejtuesve të lartë për vazhdimin e marrëdhënies së biznesit, në rastet kur marrëdhënia e biznesit me klientin është vendosur dhe subjekti konstaton që klienti apo pronari përfitues është bërë ose bëhet më pas person i ekspozuar politikisht;

ç) të marrin masa të arsyeshme për të kuptuar burimin e pasurisë dhe të fondeve të klientëve e të pronarëve përfitues, të identifikuar si persona të ekspozuar politikisht.

2. Në rastet kur subjektet kanë një marrëdhënie biznesi me personat e ekspozuar politikisht, ata duhet të mbikëqyrin me vigjilencë të zgjeruar këtë marrëdhënie.”.

Neni 5

Në nenin 9 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Shkronja “ç” e pikës 1 ndryshohet si më poshtë:

“ç) të marrin miratimin e instancave më të larta të administrimit/drejtimit dhe të dokumentojnë respektivisht për çdo institucion përgjegjësitet për parandalimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit.”.

2. Pas fjalisë së dytë të pikës 2 shtohet një fjali me këtë përmbajtje:

“Subjektet duhet të marrin masat e duhura në mënyrë që të krijojnë bindjen se bankat e huaja korrespondente nuk lejojnë që llogaritë e tyre të përdoren nga bankat guaskë.”.

3. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Subjektet duhet t’u kushtojnë vëmendje të veçantë të gjitha transaksioneve komplekse, me vlera të larta dhe të pazakonta, të cilat nuk kanë qëllim të dukshëm ekonomik ose ligjor. Subjektet duhet të analizojnë arsyet dhe qëllimin e kryerjes së transaksioneve të tilla dhe të mbajnë të dhëna për konkluzionet, të cilat duhet të mbahen për një periudhë prej pesë vjetësh dhe t’u vihen në dispozicion autoritetit përgjegjës dhe auditorëve.”.

4. Në fund të pikës 5 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Subjektet duhet të analizojnë arsyet dhe qëllimin e kryerjes së transaksioneve të tilla dhe të mbajnë të dhëna për konkluzionet, të cilat duhet t’u vihen në dispozicion autoritetit përgjegjës dhe auditorëve.”.

5. Pika 7 ndryshohet si më poshtë:

“7. Subjektet duhet të përcaktojnë për të gjithë klientët nëse ata janë duke vepruar në emër të një personi tjetër dhe duhet të marrin masa të arsyeshme për të siguruar të dhëna të mjaftueshme për identifikimin e atij personi.”.

6. Pas pikës 8 shtohen pikat 8/1, 8/2, 8/3, 8/4 dhe 8/5 me këtë përmbajtje:

8/1. Për klientët, që janë persona juridikë, subjektet duhet të marrin masa për të kuptuar strukturën e pronësisë e të kontrollit të klientit dhe për të përcaktuar se cilët janë personat që kanë në pronësi apo kontrollojnë klientin. Këtu përfshihen ata persona që ushtrojnë kontrollin e fundit efektiv mbi personin juridik.

8/2. Subjektet duhet të sigurojnë informacion për qëllimin dhe natyrën e synuar të marrëdhënies së biznesit.

8/3. Subjektet duhet të përcaktojnë procedurat dhe mjetet e menaxhimit të riskut për rastet kur klienti lejohet të vendosë dhe të përdorë marrëdhënien e biznesit para verifikimit të identitetit. Këto procedura duhet të përfshijnë një sërë masash, si kufizimin e numrit, të llojit dhe/ose të shumës së transaksioneve që mund të kryhen.

8/4. Në rastet kur subjekti ka filluar marrëdhënien e biznesit dhe është i paaftë të zbatojë detyrimin e vigjilencës së zgjeruar, të përshkruar në këtë nen, duhet të përfundojë marrëdhënien e biznesit dhe të dërgojë një raport të veprimtarisë së dyshimtë tek autoriteti përgjegjës.

8/5. Për klientët ekzistues, subjektet duhet të zbatojnë masat për vigjilencën e zgjeruar ndaj klientit, bazuar në prova, fakte dhe rrezikun.”.

7. Pika 9 ndryshohet si më poshtë:

“9. Nëse subjektet nuk mund të zbatojnë detyrimin e vigjilencës së zgjeruar të përshkruar në këtë nen:

- a) nuk duhet të hapin llogari, të fillojnë një marrëdhënie biznesi apo të kryejnë transaksionin;
- b) duhet të dërgojnë një raport të veprimtarisë së dyshimtë tek autoriteti përgjegjës.”.

Neni 6

Në nenin 11 pika 1, në fund të shkronjës “b” shtohet një fjali me këtë përmbajtje:

“Personat përgjegjës kanë akses të vazhdueshëm ndaj të gjitha të dhënave, të parashikuara në nenin 16 të këtij ligji.”.

Neni 7

Neni 12 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 12

Raportimi tek autoriteti përgjegjës

1. Subjektet i paraqesin një raport autoritetit përgjegjës, ku parashtrojnë dyshimet që kanë për rastet kur e dinë apo dyshojnë se po kryhet, është kryer apo tentohet të kryhet pastrimi i produkteve të veprës penale apo financimi i terrorizmit. Raportimi bëhet menjëherë dhe jo më vonë se periudha e përcaktuar në aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.

2. Kur subjekti, të cilit i kërkohet nga klienti të kryejë një transaksion, ka dyshime se transaksioni mund të përfshijë pastrim parash ose financim terrorizmi, ai duhet t'ia raportojë menjëherë çështjen autoritetit përgjegjës dhe të kërkojë udhëzime nëse duhet ta kryejë apo jo transaksionin. Autoriteti përgjegjës është i detyruar të kthejë përgjigje brenda 48 orëve.

3. Subjekteve u kërkohet t'i raportojnë autoritetit përgjegjës, sipas afateve të përcaktuara në aktet nënligjore, në zbatim të këtij ligji, të gjitha transaksionet në para fizike, në një vlerë të barabartë ose më të madhe se 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë ose kundërvlerën në monedha të huaja, të kryera si një transaksion i vetëm ose si transaksione të lidhura me njëra-tjetrën.

4. Subjektet e përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të nenit 3 të këtij ligji duhet t'i raportojnë autoritetit përgjegjës, sipas afateve të përcaktuara në aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji, të gjitha transaksionet jo në para fizike, në një shumë të barabartë në vlerë ose më të madhe se 6 000 000 (gjashtë milionë) lekë ose kundërvlerën në monedha të huaja, të kryera si një transaksion i vetëm ose si transaksione të lidhura me njëra-tjetrën.”.

Neni 8

Në nenin 13, fjalia e parë ndryshohet si më poshtë:

“Subjektet e ligjit përjashtohen nga detyrimi për raportim tek autoriteti përgjegjës, sipas pikës 4 të nenit 12 të këtij ligji, për transaksionet.”.

Neni 9

Pas nenit 15 shtohet neni 15/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 15/1

Mbrojtja e identitetit të subjektit raportues

Autoriteti përgjegjës dhe çdo organ tjetër, të cilët marrin raportime, të dhëna, njoftime, në zbatim të këtij ligji, në masën dhe mënyrën e përcaktuar nga legjisllacioni në fuqi, janë të detyruar të ruajnë anonimatën e subjekteve raportuese dhe të punonjësve të tyre që kanë raportuar apo kanë dhënë njoftime e të dhëna.”.

Neni 10

Në nenin 16, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Subjektet duhet të ruajnë dokumentacionin për identifikimin, llogaritë, si dhe korrespondencën me klientin për 5 vjet nga data e mbylljes së llogarisë apo përfundimit të marrëdhënies së biznesit ndërmjet klientit e subjektit. Me kërkesën e autoritetit përgjegjës, dokumentacioni ruhet për më shumë se 5 vjet.”.

Neni 11

Në nenin 21, pas pikës 4 shtohen pikat 5 e 6 me këtë përmbajtje:

“5. Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave emërohet për një periudhë 4-vjeçare, me të drejtë riemërimi.

6. Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave emërohet dhe shkarkohet sipas procedurave të Këshillit të Ministrave për emërimin dhe shkarkimin e drejtuesve të institucionit në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose ministrit.”.

Neni 12

Në nenin 22 bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja “a” ndryshohet si më poshtë:

“a) mbledh, administron, përpunon, analizon dhe shpërndan tek autoritetet kompetente të dhëna, raporte dhe informacione për çështjet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;”.

2. Shkronja “c” ndryshohet si më poshtë:

“c) për qëllime të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, kërkon çdo lloj informacioni nga subjektet që i nënshtrohen këtij ligji.”.

3. Shkronja “e” ndryshohet si më poshtë:

“e) shkëmben informacion me Prokurorinë e Përgjithshme, Ministrinë e Brendshme, Policinë e Shtetit, Shërbimin Informativ Shtetëror dhe autoritetet e tjera kompetente të zbatimit të ligjit, për çështjet e pastrimit të produkteve të veprës penale ose financimit të terrorizmit dhe mund të nënshkruajë memorandum bashkëpunimi dy ose shumëpalësh me to.”.

Neni 13

Në nenin 26 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Në shkronjën “b” të pikës 1, fjalët “dhe në aktet nënligjore” hiqen.

2. Pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Në rastin e subjekteve që ushtrojnë veprimtari bankare, në rrethanat e parashikuara nga shkronjat “a” dhe “b” të pikës 1 të këtij neni, autoriteti përgjegjës mund t’i kërkojë Bankës së Shqipërisë rritjen e shkallës së mbikëqyrjes së subjektit.”.

Neni 14

Në nenin 27 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 6 ndryshohet si më poshtë:

“6. Për rastet kur nuk zbatojnë kërkesat për raportim, të parashikuara në pikat 3 e 4 të nenit 12 të këtij ligji, subjektet gjobiten:

a) personat fizikë nga 300 000 lekë deri në 1 500 000 lekë;

b) personat juridikë nga 1 000 000 lekë deri në 5 000 000 lekë.

2. Pika 11 ndryshohet si më poshtë:

“11. Këshilli i Ministrave përcakton me vendim procedurat e konstatimit, të shqyrtimit, të propozimit dhe të vendosjes së masave administrative nga autoriteti përgjegjës. Procedurat e ankimit dhe të ekzekutimit të gjobave, të vendosura me vendim të autoritetit përgjegjës, bëhen në përputhje me ligjin “Për kundërvajtjet administrative””.

3. Pas pikës 11 shtohet pika 12 me këtë përmbajtje:

“12. E drejta për shqyrtimin e kundërvajtjeve administrative, të parashikuara në këtë nen, nuk mund të ushtrohet kur kanë kaluar 2 vjet nga çasti i kryerjes së kundërvajtjes administrative.”.

Neni 15

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6933, datë 18.3.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ
Nr.10 392, datë 10.3.2011

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE, DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË AUSTRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRI FEDERAL I FINANCAVE, PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë, përfaqësuar nga Ministri Federal i Financave, për bashkëpunimin financiar”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6934, datë 23.3.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË AUSTRISË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRI FEDERAL I FINANCAVE MBI BASHKËPUNIMIN FINANCIAR

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Qeveria e Republikës së Austrisë, përfaqësuar nga Ministri Federal i Financave, këtu quhen “Palët kontraktuese”,

- *me dëshirën* për të nxitur më tej marrëdhëniet e ngushta dhe miqësore ndërmjet të dyja vendeve;

- *me dëshirën* për të zhvilluar, zgjeruar dhe thelluar bashkëpunimin e suksesshëm në fushën financiare;

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Palët kontraktuese përpiqen të nxitin dhe zgjerojnë bashkëpunimin financiar brenda kuadrit të ligjeve, rregulloreve dhe politikave të tyre ekzistuese përkatëse.

Neni 2

Me qëllim nxitjen dhe zgjerimin e bashkëpunimit financiar, Ministri Federal Austriak i Financave është përgatitur të mbështetë dhënien e kredive për ndihmën e kushtëzuar me terma

koncesionarë, të rfinansuar nga Oesterreichische Kontrollbank Aktiengesellschaft (OeKB), Vjenë, sipas skemës së saj të financimit të eksportit.

Është parashikuar një kuadër tregues financiar deri në 40, 000, 000 euro (dyzet milionë) me bazë përjashtimore për një periudhë prej dy vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Pjesa e papërdorur e Marrëveshjes pararendëse, e nënshkruar më 3 qershor 2008, dhe në fuqi për dy vjet nga data 1 nëntor 2008, mund të përdoret përveç kësaj për të financuar projekte të përshtatshme sipas kësaj Marrëveshjeje.

Neni 3

Termat dhe kushtet e huave do të caktohen në pajtim me detyrimet ndërkombëtare që rrjedhin nga “Marrëveshja për kreditë e eksportit të mbështetura zyrtarisht” nën kujdesin e OBZHE-së. Niveli i koncesionit do të jetë përkatësisht të paktën 35%.

Përshtatshmëria e projekteve që do të financohen vlerësohet duke marrë parasysh udhëzimet mëparshme të përfuara sipas disiplinave të ndihmës së kushtëzuar “Helsinki”, si dhe kriteret e brendshme të zbatueshme për alokimin.

Neni 4

Marrëveshjet e huave të rfinansuara nga OeKB-ja negociohen drejtpërdrejt ndërmjet bankave tregtare si huadhënës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave.

Neni 5

Të dyja palët bien dakord të respektojnë procedurën e përshkruar në aneksin për projektet që janë planifikuar të realizohen në bazë të kësaj Marrëveshjeje.

Përfshirja e projekteve në këtë Marrëveshje miratohet nëpërmjet shkëmbimit të letrave ndërmjet Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë Federale të Financave të Republikës së Austrisë. Kjo realizohet në mënyrë të njëpasnjëshme gjatë një periudhe 24-mujore duke filluar nga data e hyrjes në fuqi e kësaj Marrëveshjeje. Projektet që janë në fazën e negociatave para hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje mund të përfshihen, megjithatë, njoftimet e projekteve sipas rregullave të OBZHE-së mund të bëhen vetëm deri më 7 korrik 2012.

Neni 6

Huatë e dhëna duhet të përdoren për blerjen e mallrave dhe shërbimeve austriake, që mund të përfshijnë deri në 50% të mallrave dhe shërbimeve me origjinë nga jashtë Austrisë.

Neni 7

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, i përfaqësuar nga Ministria e Financave, garanton në mënyrë të pakthyeshme dhe pa kusht kryerjen e të gjithave pagesave që rrjedhin nga huat koncesionare austriake të dhëna sipas kësaj Marrëveshjeje. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, i përfaqësuar nga Ministria e Financave, heq dorë në mënyrë të pakthyeshme nga çdo pretendim për imunitet ndaj padisë ose ekzekutimit, për të cilin mund të ketë të drejtë në lidhje me pagesat e garantuara sipas kësaj Marrëveshjeje.

Neni 8

Të gjitha pagesat në lidhje me huat koncesionare përjashtohen nga të gjitha tatimet dhe detyrimet e vendosura nga pala shqiptare.

Neni 9

Palët kontraktuese, çdo vit ose kurdoherë që konsiderohet e nevojshme nga palët kontraktuese, rishikojnë progresin e bërë në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 10

Me qëllim vlerësimin e përdorimit të huave koncesionare të dhëna në bazë të kësaj Marrëveshjeje dhe qëndrueshmërinë e projekteve përkatëse, Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë do të lehtësojë dhënien e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm për vlerësimin, auditimin dhe monitorimin e projekteve.

Neni 11

Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve kontraktuese në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e kësaj marrëveshjeje zgjidhet me pajtim nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 12

Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje hyjnë në fuqi në ditën e parë të muajit, pas muajit në të cilin palët kontraktuese kanë njoftuar njëra-tjetrën për përmbushjen e të gjitha procedurave të nevojshme në vendin përkatës. Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë dyvjeçare dhe mund të zgjatet, vetëm për çështje procedurale, gjithashtu, me pëlqim reciprok nëpërmjet shkëmbimit të letrave.

Bërë në dy kopje origjinale, të dyja në gjuhën angleze.

ANEKS

Hapi 1

Idetë për projektet që shqyrtohen për t'u financuar sipas skemës austriake për huat e buta mund të paraqiten nga të dyja palët për diskutim.

Hapi 2

Komentet i komunikohen palës përkatëse.

Hapi 3

Mbi bazën e këtij informacioni mund të fillohen procedurat e tenderimit. Pala shqiptare mund të marrë parasysh vetëm oferta nga eksportuesit austriakë, për të cilët ajo ka marrë letra konfirmimi (shih hapin 4) deri në mbylljen e tenderimit.

Hapi 4

Sapo të jenë bërë vlerësimet e nevojshme dhe dhënë aprovimet, pala austriake do të vërë në dispozicion një letër konfirmimi nëpërmjet Oesterreichische Kontrollbank AG (OeKB) për shoqërinë austriake.

Hapi 5

Bazuar në dhënien e tenderit, mund të finalizohen kontratat e furnizimit dhe marrëveshjet e huas.

Hapi 6

Projektet, për të cilat janë nënshkruar kontratat e furnizimit dhe marrëveshjet e huas, mund të përfshihen në Marrëveshje nëpërmjet shkëmbimit të letrave në pajtim me nenin 5 të Marrëveshjes.

Hapi 7

Në pajtim me nenin 10 të Marrëveshjes, Shqipëria do të mundësojë dhënien e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm për vlerësimin, auditimin dhe monitorimin e projekteve të realizuara.

LIGJ
Nr.10 393, datë 10.3.2011

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË KREDISË SË EKSPORTIT NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA
MINISTRIA E FINANCAVE, DHE UNICREDIT BANK AUSTRIA PËR FINANCIMIN E
PËRMIRËSIMIT TË DEPARTAMENTIT TË NEUROKIRURGJISË PËR SPITALIN
UNIVERSITAR “NËNË TEREZA””**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e kredisë së eksportit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Unicredit Bank Austria për financimin e përmirësimit të Departamentit të Neurokirurgjisë për Spitalin Universitar “Nënë Tereza””.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6935, datë 23.3.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

MARRËVESHJE KREDIE EKSPORTI

Hua e butë nr.230.916 për një shumë prej 7,100,000 euro e datës.....2010 e lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, që vepron në emër të Republikës së Shqipërisë dhe përfaqësuar nga Ministria e Financave (si “Huamarrësi”) dhe UniCredit Bank Austria AG (si “Huadhënësi”) në lidhje me financimin e përmirësimit të Departamentit Neurokirurgjikal të spitalit “Nënë Tereza”, Tiranë

Kjo marrëveshje kredie eksporti për huan e butë nr.230.916 për një shumë prej 7,100,000 euro (Marrëveshja) e datës2010 është lidhur ndërmjet Huamarrësit të përcaktuar në aneksin 1 (Huamarrësi) dhe Huadhënësit (Huadhënësi) të përcaktuar në aneksin 1.

1. PËRKUFIZIMET

Në këtë Marrëveshje dhe në anekset e saj, shprehjet e mëposhtme kanë kuptimet e mëposhtme:

“Data e pranimit” nënkupton datën në të cilën Marrëveshja është nënshkruar nga të dyja palët dhe është ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

“Aneksi” nënkupton një aneks të kësaj Marrëveshjeje, termat e të cilit konsiderohen të përfshira në këtë Marrëveshje dhe formojnë pjesë përbërëse të saj.

“Periudha e disponueshmërisë” nënkupton periudhën e përcaktuar në aneksin 3, gjatë së cilës huamarrjet mund të tërhiqen nga shuma e kredisë.

“Huamarrje” nënkupton një shumë të tërhequr nga Huamarrësi nga shuma e kredisë.

“Ditë pune” nënkupton një ditë në të cilën bankat janë hapur për punë dhe transaksionet dhe depozitat në valutë të huaj ndërmjet bankave mund të zhvillohen në Vjenë dhe në Tiranë.

“Data e mbylljes” nënkupton datën e përcaktuar në seksionin 7 të kësaj Marrëveshjeje.

“Shuma e kredisë” nënkupton shumën e përcaktuar në aneksin 3 nga e cila Huamarrësi mund të tërheqë huamarrje gjatë periudhës së disponueshmërisë.

“Euro” ose “€” monedha e vetme e atyre shteteve anëtare të Bashkimit Europian që miratojnë Euron si monedhën e tyre në përputhje me legjislacionin e Komunitetit Europian në lidhje me Bashkimin Monetar dhe Ekonomik Europian.

“Euribor” nënkupton normën e përqindjes në vit, të barabartë me vlerën që duhet të paguhet brenda një afati sa më të shpejtë mbi bazën e një rregulli 365/360 të normës mesatare të depozitave EURIBOR, siç është rënë dakord me EURIBOR FBE (faqja 248) për një periudhë të barabartë me periudhën për të cilën interesi duhet të përcaktohet nga Huadhënësi (seksioni 3.3) në ose rreth orës 11:00 të Brukselit në ditën e dytë të punës para fillimit të periudhës përkatëse të interesit. Në këtë kontekst, “FBE” nënkupton “Federation Bancaire Europeenne”.

“Llogaria e shumës” nënkupton llogarinë e hapur në emër të Huamarrësit në përputhje me dispozitat e seksionit 2.3.

“Datat e pagesës së interesit” nënkuptojnë datat: 31 mars, 30 qershor, 30 shtator dhe 31 dhjetor në çdo vit, me kusht që nëse një datë e tillë nuk do të jetë ditë pune, referencat ndaj kësaj date do të jenë ndaj ditës së punës pararendëse.

“Periudha e interesit” nënkupton një periudhë:

i) që fillon në datën e Huamarrjes ose në ditën e fundit të periudhës së saj pararendëse të interesit; dhe

ii) që përfundon më 31 mars, 30 qershor, 30 shtator ose 31 dhjetor të çdo viti.

“E drejta e mbajtjes” nënkupton çdo hipotekë, detyrim, peng, të drejtë mbajtjeje, hipotekim, barrë, ruajtje titulli ose interes tjetër garancie të çdo lloji dhe të lindur në çfarëdolloj mënyre.

“Huaja” nënkupton shumën e përgjithshme të principalit të huamarrjeve të parapaguar sipas shumës së kredisë dhe që është e papaguar për kohën në vazhdim.

“Datat e shlyerjes së detyrueshme” nënkuptojnë datat në çdo vit të përcaktuara në aneksin 3, me kusht që nëse një datë e tillë nuk do të jetë ditë pune, referencat ndaj kësaj date do të jenë ndaj ditës së punës pararendëse.

“OeKB” nënkupton Oesterreichische Kontrollbank Aktiengesellschaft, Am Hof 4, 1011, Vienna, Austria, që vepron si Agjencia e Kredisë së Eksportit për dhe në emër të Republikës së Austrisë.

“Garancia e OeKB-së” nënkupton një garanci të lëshuar nga OeKB-ja si agjenti i Republikës së Austrisë.

“Procedura e pagesës” nënkupton procedurën për pagesën e huamarrjeve të përcaktuara në aneksin 4.

“Projekti” nënkupton projektin e përcaktuar në aneksin 2.

“Blerësi i projektit” nënkupton blerësin e projektit të përcaktuar në aneksin 2.

“Eksportuesi i projektit” nënkupton eksportuesin austriak të përcaktuar në aneksin 2.

“Data e përkohshme e pranimit” nënkupton datën në të cilën Huadhënësi ka marrë nga eksportuesi i projektit kopjen e COHO-s (siç përcaktohet në Marrëveshjen e Blerjes);

“Marrëveshja e blerjes” nënkupton marrëveshjen në lidhje me projektin, të lidhur ndërmjet eksportuesit të projektit dhe blerësit të projektit dhe të përcaktuar në aneksin 2.

“Seksioni” nënkupton një seksion të kësaj Marrëveshjeje.

2. SHUMA E KREDISË

2.1 Preambula

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është të përcaktojë termat dhe kushtet mbi bazën e të cilave Huadhënësi do të financojë 100% të vlerës totale të kontratës (por deri në shumën maksimale të përcaktuar si “Shuma e kredisë” në aneksin 3 të saj), që duhet të paguhet nga blerësi i projektit për eksportuesin e projektit sipas Marrëveshjes së Blerjes.

2.2 Shuma e kredisë

Me anë të kësaj Marrëveshjeje, Huadhënësi bie dakord të vërë në dispozicion shumën e kredisë për Huamarrësin gjatë periudhës së disponueshmërisë mbi bazën e termave dhe kushteve të parashtruara në këtë Marrëveshje, me kusht që një Huamarrje të mund të bëhet vetëm nga Huamarrësi sipas shumës së kredisë në përputhje me procedurën e pagesës të përcaktuar në aneksin 4 dhe të aplikohet kundrejt pagesës së çmimit të kërkueshëm për eksportuesin e projektit sipas Marrëveshjes së blerjes.

Kredia e dhënë si më poshtë, jepet nën dhe sipas dispozitave të rregullave dhe rregulloreve për kreditë e eksportit të shpallura nga Republika e Austrisë. Huamarrësi vlerëson se financimi mbështetet nga fondet e ndihmës publike me një element granti prej 35,74% (tridhjetë e pesë pikë shtatëdhjetë e katër për qind).

Huadhënësi mund të refuzojë të livrojë një Huamarrje nëse kjo Huamarrje dhe interesi mbi të nuk do të mbulohej nga garancia e lëshuar nga OeKB-ja për dhe në emër të Republikës së Austrisë, në përputhje me ligjin mbi nxitjen e eksportit, të ndryshuar, dhe/ose marrëveshja e rifinancimit me OeKB-në për shumën e kredisë pushon së qeni në fuqi.

2.3 Llogaria e shumës

Huadhënësi hap një llogari në euro në emër të Huamarrësit, e quajtur “Llogaria e shumës”. Çdo Huamarrje e bërë si më poshtë debitohet në llogarinë e shumës, në përputhje me këtë Marrëveshje, e vlefshme në datën e pagesës të kësaj Huamarrjeje. Rrjedhimisht, shlyerjet dhe parapagesat aplikohen në llogarinë e shumës.

2.4 Pavarësia e Marrëveshjes dhe e Marrëveshjes së Blerjes

Kjo Marrëveshje dhe Marrëveshja e Blerjes janë marrëveshje të veçanta dhe të pavarura. Asnjë paaftësi e eksportuesit të projektit për të përmbushur detyrimet e tij sipas Marrëveshjes së Blerjes nuk cenon detyrimet e Huamarrësit ndaj Huadhënësit, as nuk e bën Huadhënësin përgjegjës për ndonjë mosplotësim detyrimi nga eksportuesi i projektit dhe/ose ndonjë pale tjetër të Marrëveshjes së Blerjes.

3. INTERESI

3.1 Interesi mbi llogarinë e shumës

Huamarrësi paguan interes në datat e pagesës së interesit në një normë fikse të përcaktuar në aneksin 3, të llogaritur mbi shumën e papaguar të kredisë.

3.2 Llogaritja dhe data për pagesën e interesit

Interesi i kërkueshëm në përputhje me seksionin 3.1 rritet ditë pas dite, llogaritet mbi bazën e numrit aktual të ditëve të kaluara për periudhën përkatëse të interesit dhe një viti prej 360 ditësh dhe përveç kur parashikohet në seksionin 6.1, do të paguhet çdo tre muaj në shuma të prapambetura nga Huamarrësi për Huadhënësin në datat e pagesës së interesit.

3.3 Kamatëvonesa

Në rast të paaftësisë së Huamarrësit për të kryer pagesa në datën e kërkueshme të çdo shume të kërkueshme, si më poshtë, Huamarrësi do të paguajë interes mbi këtë shumë nga data e këtij mosplotësimi detyrimi deri në datën e pagesës aktuale në normën e përcaktuar në aneksin 3. Kamatëvonesa sipas këtij seksioni 3.3 do të jetë e kërkueshme në datat e pagesës së interesit.

4. TARIFAT DHE SHPENZIMET

4.1 Tarifa e angazhimit

Për periudhën që fillon në datën e mbylljes dhe që përfundon në fund të periudhës së disponueshmërisë, Huamarrësi i paguan Huadhënësit një tarifë angazhimi në normën e përcaktuar në aneksin 3. Tarifa e angazhimit e kërkueshme në përputhje me këtë seksion 4.1, llogaritet mbi bazën e numrit aktual të ditëve të kaluara dhe një viti prej 360 ditësh nga Huadhënësi mbi balancën e patërhequr të shumës së kredisë në fillim të çdo tremujori kalendarik dhe paguhet në shuma të prapambetura nga Huamarrësi për Huadhënësin në datat e pagesës së interesit. Pagesa e parë e tarifës së angazhimit, si më poshtë, do të bëhet në datën e pagesës së parë të interesit pas datës së mbylljes.

4.2 Tarifa e drejtimit

Brenda 30 ditëve kalendarike pas datës së mbylljes (por jo më vonë se 5 ditë pune para livrimit të parë të shumës së kredisë) Huamarrësi do t'i paguajë Huadhënësit tarifën e drejtimit të përcaktuar në aneksin 3.

4.3 Shpenzimet

i) Huamarrësi i paguan më tej Huadhënësit, sipas kërkesës, shpenzimet e arsyeshme dhe të dokumentuara (duke përfshirë shpenzimet ligjore, të përkthimit dhe udhëtimit, dhe shpenzimet në lidhje me garancinë së OeKB-së), të shkaktuara nga Huadhënësi në kërkesë padinë për zhdëmtim ose kompensim të çdo shume të kërkueshme për Huadhënësin, si më poshtë:

ii) Të gjitha taksat, tatimet, shpenzimet ose tarifatat e tjera të vendosura ndaj Huadhënësit nga Ministria e Financave, Shqipëri, në lidhje me këtë Marrëveshje dhe transaksionet e parashikuara më poshtë, janë për llogari të Huamarrësit dhe të pagueshme nga Huamarrësi për Huadhënësin.

4.4 Primi i garancisë

Sipas Marrëveshjes, Huadhënësi i ngarkon Huamarrësit një kompensim për prim të garancisë së OeKB-së në mënyrën e mëposhtme:

i) Primi i garancisë së OeKB-së dhe tarifa e drejtimit të OeKB-së, të pagueshme të parapaguar brenda 30 ditëve kalendarike pas datës së mbylljes (por jo më vonë se 5 ditë pune para livrimit të parë të shumës së kredisë), Huamarrësi do t'i paguajë Huadhënësit një pjesë të parapaguar për kompensimin për primin e garancisë të OeKB-së dhe tarifën e drejtimit të përcaktuar në aneksin 3 në shumat e përcaktuara në aneksin 3.

ii) Primi i garancisë së OeKB-së i pagueshëm si marzh.

Duke filluar nga data e pagesës së interesit që bie pas datës së mbylljes, Huamarrësi do t'i paguajë Huadhënësit kompensimin për primin e garancisë së OeKB-së të pagueshme si marzh, të përcaktuar në aneksin 3. Marzhi i primit të garancisë së OeKB-së, është i kërkueshëm dhe i pagueshëm çdo tre muaj në datat e pagesës së interesit.

Grafiku i pagesës së shumave që duhet të paguhen sipas seksionit 4.4, përcaktohet në garancinë përfundimtare të lëshuar nga OeKB-ja. Huadhënësi informon Huamarrësin përkatësisht për lëshimin e garancisë dhe grafikun e pagesës dhe ky njoftim bëhet pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.

Nëse gjatë afatit të Marrëveshjes së Eksportit të Kredisë, primi i garancisë së OeKB-së rritet, sepse: (i) vlerësimi i rrezikut komercial i bërë nga OeKB-ja në lidhje me lëshimin e garancisë së OeKB-së, ka ndryshuar; ose (ii) janë miratuar ndryshimet materiale në termat kontraktuale të Marrëveshjes së Kredisë së Eksportit, Huamarrësi do të riimburojë Huadhënësin për këtë rritje, sipas kërkesës.

5. SHLYERJA

5.1 Shlyerja e detyrueshme

Huaja e papaguar në fund të periudhës së disponueshmërisë do të shlyhet nga Huamarrësi në një numër këstesh të barabarta gjashtëmujore shlyerjeje në datat e shlyerjes së detyrueshme, të përcaktuara në aneksin 3. Brenda 15 ditëve kalendarike pas datës së pranimit të përkohshëm, Huadhënësi do të njoftojë Huamarrësin për listën e datave të shlyerjes së detyrueshme dhe shumat e kërkueshme në secilën prej këtyre datave.

5.2. Parapagimi opsional

Huamarrësi mund të parapaguajë të gjithën ose ndonjë pjesë (në rast të parapagimit të pjesshëm, në shumën e përcaktuar në aneksin 3 ose shumëfishat integralë të saj) të huas, pas dhënies së një njoftimi me shkrim, të paktën tridhjetë (30) ditë para (ky njoftim duhet të jetë i parevokueshëm) nga data e propozuar e parapagimit për Huadhënësin në bazë të miratimit të OeKB-së dhe pagesave të ndonjë shpenzimi para afatit të shkaktuara nga Huadhënësi. Çdo parapagim i tillë, nëse bëhet gjatë periudhës së disponueshmërisë, do të zvogëlojë shumën e kredisë me një shumë të barabartë me këtë parapagim. Çdo referencë ndaj shumës së kredisë në këtë Marrëveshje konsiderohet më pas të jetë referencë ndaj shumës së përcaktuar në aneksin 3, të zvogëluar. Çdo parapagim i tillë, nëse bëhet pas skadimit të periudhës së disponueshmërisë, do të aplikohet për të zvogëluar me shumën e barabarta këstet e shlyerjes të kërkueshme më pas.

6. PAGESAT

6.1 Njoftimi i pagesës

Jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike para çdo date të pagesës së interesit ose sipas rastit, datës së shlyerjes së detyrueshme, Huadhënësi do të njoftojë Huamarrësin për ato shumë që janë të kërkueshme për t'u paguar nga Huamarrësi për Huadhënësin, në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje në lidhje me principalin, interesin dhe tarifën e angazhimit, me kusht që paaftësia për dhënie e këtij njoftimi të lartpërmendur, të mos lehtësojë Huamarrësin nga detyrimi i tij për të bërë pagesa të këtyre shumave të lartpërmendura kur ato bëhen të kërkueshme.

Njoftimi përcakton, gjithashtu, për secilën pagesë, që duhet të bëhet sipas kësaj Marrëveshjeje, shumën e saktë dhe qëllimin e pagesës (caktimi për shumat e kërkueshme dhe të pagueshme të njoftuara nga Huadhënësi) dhe Huamarrësi kryen pagesën në mënyrën e rekomanduar dhe konfirmon kërkesën me shkrim për fonde. Huamarrësi informon Huadhënësin me shkrim për qëllimin e pagesës (caktimi i fondeve) për çdo shumë të paguar nga Huadhënësi. Nëse nuk është marrë asnjë informacion i tillë, zbatohet seksioni 6.6.

Nëse çdo lloj shume debitohet dhe/ose kreditohet në llogarinë e shumës dhe/ose çdo llogari tjetër që mund të hapet në lidhje me këtë Marrëveshje në çdo kohë brenda pesëmbëdhjetë ditëve kalendarike para çdo date të pagesës së interesit, interesi ose çdo shumë tjetër e kërkueshme në lidhje me të cilën në këtë datë të pagesës së interesit, do të barten dhe do të bëhen të kërkueshme dhe të pagueshme për Huadhënësin në datën e ardhshme pasuese të pagesës së interesit (në rast të shumave të kredituara) do të rillogaritet përkatësisht në datën e ardhshme pasuese të pagesës së interesit.

6.2 Metoda e pagesës

Në çdo datë të pagesës së interesit, data e shlyerjes së detyrueshme ose çdo datë tjetër e kërkueshme për pagesën e çdo shume të kërkueshme dhe të pagueshme sipas kësaj Marrëveshjeje, sipas rastit, Huamarrësi do të kryejë pagesën e shumave dhe monedhës të kërkueshme në këtë datë nga Huamarrësi sipas kësaj Marrëveshjeje në Vjenë, e vlefshme në datën e kërkueshme përkatëse.

Të gjitha pagesat nga Huamarrësi për Huadhënësin të shumave të kërkueshme, si më poshtë, do të bëhen në Vjenë në euro lirisht të konvertueshme dhe të transferueshme.

6.3 Heqja dorë nga kompensimi ose kundërkërkesa

Huamarrësi heq dorë nga secila dhe të gjitha të drejtat e kompensimit ose kundërkërkesës që mund të ketë në lidhje me ndonjë shumë të kërkueshme për Huadhënësin, si më poshtë, dhe bie dakord që nuk do të mbajë pagesë për çfarëdo arsye të ndonjë shume të kërkueshme për t'u paguar. Në veçanti, Huamarrësi nuk do të mbajë pagesa të shumave të kërkueshme për Huadhënësin, sipas kësaj Marrëveshjeje, për arsye se ai ka ndonjë pretendim, të drejtë padie, të drejtë të ligjshme ose kërkesa kundër eksportuesit të projektit ose furnizuesve të tjerë në lidhje me projektin.

6.4 Pagesat pa taksa të mbajtura dhe tarifa të tjera

Të gjitha pagesat që duhet të bëhen nga Huamarrësi, sipas kësaj Marrëveshjeje, do të bëhen pa kompensim ose kundërkërkesë dhe do të jenë të lira nga dhe pa zbritje për ose në llogari të çdo takse, tatimi, shume të zbritur ose të mbajtur, ose tarifa të tjera të tashme ose të ardhshme të cilësdo lloj natyre të Republikës së Shqipërisë nëse Huamarrësit nuk i kërkohet me ligj ta bëjë këtë zbritje. Nëse kërkohet me ligj, shuma e kërkueshme nga Huamarrësi në lidhje me këtë pagesë, do të rritet në shkallën e nevojshme, për të garantuar që pas kësaj zbritjeje të taksave, tatimeve, shumave të zbritura, të mbajtura ose tarifave të tjera, Huadhënësi merr në datën e kërkuar për këtë pagesë një shumë neto të barabartë me shumën që do të kishte marrë nëse kjo zbritje e taksave, tatimeve, shumave të zbritura, të mbajtura ose tarifave të tjera nuk do të ishte kërkuar të bëhej. Huamarrësi do t'i japë menjëherë Huadhënësit fatura, vërtetime ose dëshmi të tjera që provojnë shumat (nëse ka) të paguara ose të pagueshme në lidhje me ndonjë shumë të zbritur ose të mbajtur të lartpërmendur.

6.5. Kostot e rritura

Nëse rezultati:

- i një ndryshimi ose prezantimi të ndonjë ligji, rregulloreje ose kërkese rregullatore, ose ndryshimi në interpretimin ose zbatimin e kësaj marrëveshjeje; ose

- i pajtueshmërisë së Huadhënësit me ndonjë udhëzim, kërkesë ose kusht (që ka forcën e ligjit apo jo) të një banke qendrore, autoriteti monetar, rregullator ose autoriteti tjetër;

(duke përfshirë, në çdo rast, pa kufizim, ato që kanë lidhje me mjaftueshmërinë e kapitalit, likuiditetin, asetet rezervë dhe depozitat e veçanta) është:

a) të rrisë koston ose të vendosë një kosto shtesë për Huadhënësin në vënien në dispozicion ose ruajtjen e angazhimit të tij, ose mbajtjen ose financimin e huasë; dhe/ose

b) të zvogëlojë shumën e pagueshme ose kthimin efektiv për Huadhënësin sipas kësaj Marrëveshjeje; dhe/ose

c) të zvogëlojë normën e kthimit të Huadhënësit mbi kapitalin e tij të përgjithshëm për shkak të një ndryshimi në mënyrën në të cilën ai kërkohet për të alokuar burimet e kapitalit për detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje; dhe/ose

d) të kërkojë Huadhënësit të bëjë një pagesë ose të paraprijë një kthim shume ose të llogaritur duke iu referuar ndonjë shume të marrë ose që duhet të merret nga ai sipas kësaj Marrëveshjeje,

atëherë Huamarrësi do t'i paguajë Huadhënësit, sipas kërkesës, një kosto, ulje, pagesë ose kthim të tillë të paracaktuar.

Çdo vërtetim i Huadhënësit për këtë kosto, ulje, pagesë ose kthim të paracaktuar, në mungesë të një gabimi flagrant, do të jetë provë e pakundërshtueshme dhe detyruese për Huamarrësin.

Për qëllim të kësaj klauzole, Huadhënësi mund të alokojë ose shpërndajë në mirëbesim kostot dhe/ose humbjet midis aktivëve dhe pasivëve të tij (ose ndonjë kategorie të tyre) mbi atë bazë që ata e çmojnë të përshtatshme.

6.6 Caktimi i pagesave

Të gjitha pagesat e marra nga Huadhënësi nga Huamarrësi, si më poshtë (nëse Huadhënësi nuk ndryshon urdhrin e aplikimit), duhet të zbatohen nga Huadhënësi kundrejt pagesës së shumave të kërkueshme më poshtë në rendin e mëposhtëm dhe Huamarrësi bie dakord për aplikimin e këtyre pagesave me këtë rend (dhe për çdo ndryshim të tyre nga Huadhënësi):

- a) shumat e kërkueshme sipas seksionit 4.2 (tarifa dhe shpenzimet e drejtimit);
- b) shumat e kërkueshme sipas seksionit 4.3 (primi i garancisë së OeKB-së);
- c) shumat e kërkueshme sipas seksionit 4.1 (tarifa e angazhimit);
- d) shumat e kërkueshme sipas seksionit 3.3 (kamatëvonesa);
- e) shumat e prapambetura sipas seksionit 3.1 (interesi);
- f) shumat e prapambetura sipas seksionit 5.1 (shlyerja e detyrueshme);
- g) shumat e kërkueshme sipas seksionit 3.1 (interesi);
- h) shumat e kërkueshme sipas seksionit 5.1 (shlyerja e detyrueshme);
- i) shumat e kërkueshme sipas seksionit 5.2 (parapagimi opsional).

Huadhënësi informon Huamarrësin rreth aplikimit të fondeve. Shumat e prapambetura shlyhen para shumave të kërkueshme. Çdo udhëzim për të kundërtën, i dhënë nga Huamarrësi, nuk merret në konsideratë.

Huamarrësi pranon që sipas garancisë së OeKB-së të ketë rezervuar ndaj Huadhënësit të drejtën për të ndryshuar caktimin e pagesave të përcaktuara më sipër. Në këtë rast, Huadhënësi do të informojë menjëherë Huamarrësin, me shkrim dhe Huamarrësi do të pranojë caktimin e OeKB-së dhe në këtë mënyrë merr përsipër të shlyejë huan dhe çdo shumë tjetër të papaguar sipas kësaj Marrëveshjeje të njoftuar në atë kohë (duke përfshirë një llogaritje të hollësishme) nga Huadhënësi për Huamarrësin.

7. KUSHTET PARAPRAKE

Kjo shumë kredie do të vihet në dispozicion për Huamarrësin në datën (data e mbylljes) kur Huamarrësi merr njoftim nga Huadhënësi se kushtet e mëposhtme janë përmbushur në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Huadhënësin:

- i) Huadhënësi do të ketë marrë:
 - a) një kopje të Marrëveshjes së Blerjes të pranueshme në formë dhe të pranueshme për Huadhënësin së bashku me një vërtetim nga eksportuesi i projektit në një datë jo më shumë se katërmëdhjetë ditë kalendrike para datës së mbylljes, me qëllim që Marrëveshja e Blerjes në formën, e paraqitur për Huadhënësin, të jetë në fuqi dhe efekt të plotë (aneksi 6);
 - b) një opinion të Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Shqipërisë, të pranueshëm për Huadhënësin, me atë përmbajtje që mund të kërkojë Huadhënësi (sipas aneksit 5), së bashku me kopje të vërtetuara të çdo miratimi ose autorizimi të përmendur në këtë opinion;
 - c) një kopje të vendimit të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë që miraton në parim këtë Marrëveshje;
 - d) një prokurë të lëshuar nga Kryeministri i Republikës së Shqipërisë që autorizon një person ose persona të caktuar për të nënshkruar këtë Marrëveshje dhe të gjitha dokumentet dhe njoftimet e tjera që duhet të nënshkruhen dhe/ose shpërndahen në lidhje me këtë Marrëveshje;
 - e) një kopje origjinale të kësaj Marrëveshjeje të nënshkruar rregullisht nga një person ose persona të autorizuar me prokurën e përmendur në paragrafin (d) më sipër;
 - f) ekzemplarë firmash të vërtetuara të personit ose personave të autorizuar për të nënshkruar të gjitha dokumentet dhe njoftimet e tjera që duhet t'i jepen Huadhënësit më poshtë në emër të Huamarrësit;
 - g) një emërim të një agjenti veprues për Huamarrësin në Republikën e Austrisë për Marrëveshjen (aneksi 7);
 - h) çdo dokument, provë ose autorizim tjetër që Huadhënësi mund të kërkojë, me qëllim që të realizojë këtë Marrëveshje dhe transaksionet e parashikuara më poshtë nga një marrëveshje ligjore, të vlefshme, detyruese dhe të zbatueshme.

ii) Huadhënësi do të ketë marrë:

a) garancinë e lëshuar nga OeKB-ja për dhe në emër të Republikës së Austrisë, në përputhje me ligjin e nxitjes së eksportit të vitit 1981, të ndryshuar, termat dhe kushtet e të cilit mund të përmbushen nga Huadhënësi;

b) një marrëveshje rifinancimi me OeKB-në për huan;

c) një marrëveshje plotësuese me eksportuesin e projektit dhe miratimi nga autoritetet e Huadhënësit të kësaj Marrëveshjeje.

iii) Çdo kusht plotësues (nëse ka) të kërkuar në garancinë e Republikës së Austrisë të lëshuar nga OeKB-ja.

Me përmbushjen e të gjitha kushteve të lartpërmendura, Huadhënësi do të njoftojë menjëherë Huamarrësin për këtë qëllim. Nëse këto kushte nuk do të jenë përmbushur brenda periudhës së mbylljes të përcaktuar në aneksin 3 të kësaj Marrëveshjeje, pa cenuar detyrimin e Huamarrësit, sipas seksionit 4.2, kjo Marrëveshje do të pushojë së qeni detyruese për palët.

Secili prej dokumenteve dhe njoftimeve të lartpërmendura do të jetë në gjuhën angleze ose gjermane. Nëse nuk është në gjuhën angleze ose gjermane, një përkthim i vërtetuar në gjuhën angleze i bashkëlidhet dokumentit të mësipërm.

8. RASTE TË MOSPLOTËSIMIT TË DETYRIMEVE

8.1 Raste të mosplotësimit të detyrimeve

Secili prej rasteve të mëposhtme përbën një rast të mosplotësimit të detyrimeve:

a) ekziston një paaftësi paguese për më shumë se katërmëdhjetë (14) ditë kalendarike nga Huamarrësi të ndonjë principalit, interesi ose shume tjetër të kërkueshme në lidhje me huan; ose

b) Huamarrësi është i paaftë për të përmbushur ose respektuar siç duhet ndonjë kusht ose sipërmarrje në përmbajtje të kësaj Marrëveshjeje, të ndryshme nga pagesa e principalit, interesit ose shumave të tjera për një periudhë prej tridhjetë (30) ditësh kalendarike nga data më e hershme në të cilën Huamarrësi vihet në dijeni të paaftësisë dhe datës në të cilën njoftimi me shkrim për këtë paaftësi që kërkon nga Huamarrësi ta kompensojë këtë, do t'i jetë dhënë më parë Huamarrësit nga Huadhënësi; ose

c) çdo garanci ose sipërmarrje të bërë nga Huamarrësi në lidhje me këtë Marrëveshje do të rezultojë të ketë qenë e pavërtetë në aspekte materiale në kohën kur është bërë; ose

d) Huamarrësi do të jetë në mosplotësim të pagesës ose përmbushjes së ndonjë detyrimi në lidhje me paratë e marra hua, të ndryshme nga huaja (duke përfshirë në çdo rast një detyrim sipas një garancie); ose

e) çdo licencë, pëlqim, regjistrim ose aprovim (qeveritar apo ndryshe) i kërkuar për vlefshmërinë, zbatueshmërinë ose ligjshmërinë e kësaj Marrëveshjeje ose huaje ose realizimi i të cilave është tërhequr ose pushon për ndonjë arsye së qeni në fuqi dhe efekt të plotë; ose

f) Republika e Shqipërisë shpall një moratorium të përgjithshëm për detyrimet e pagesës ndaj kreditorëve të saj; ose

g) çdo ngjarje që ka në diskrecionin e arsyeshem të Huadhënësit një ndikim të rëndë material në aftësinë e Huamarrësit për të përmbushur detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje; ose

h) garancia e Republikës së Austrisë të lëshuar nga OeKB-ja ose ndonjë prej dispozitave të saj është revokuar, ka përfunduar ose ka pushuar së qeni në fuqi dhe efekt, ose ka pushuar së dhëni garancinë e synuar ose bëhet e paligjshme, ose shpallet e pavlefshme për një arsye, raste ose rrethana që mund t'i atribuohen sferës së Huamarrësit.

8.2 Masat për rastet e mosplotësimit të detyrimeve

Nëse ka ndodhur një rast i mosplotësimit të detyrimeve dhe në çdo kohë më pas do të jetë i vazhdueshëm, ndonjë ose të gjitha prej masave të mëposhtme, mund të merren nga Huadhënësi:

a) me anë të një njoftimi me shkrim drejtuar Huamarrësit, Huadhënësi mund të shpallë principalin dhe interesin e shtuar në lidhje me huan dhe të gjitha shumat e tjera të pagueshme, si më poshtë, si menjëherë të kërkueshme dhe të pagueshme, dhe më pas do të bëhen menjëherë të kërkueshme dhe të pagueshme, pa parashtrim, kërkesë, kundërshtim ose njoftim tjetër të çdo lloji;

b) me anë të një njoftimi me shkrim drejtuar Huamarrësit, Huadhënësi mund të shpallë të përfunduar shumën e kredisë, pas së cilës detyrimi i Huadhënësit për të realizuar dhe vazhduar huan, si më poshtë, do të përfundojë menjëherë; dhe

c) çdo masë tjetër që Huadhënësi mund të vendosë të marrë sipas diskrecionit të tij absolut.

Huamarrësi bie dakord t'i paguajë Huadhënësit, sipas kërkesës, të gjitha humbjet, shpenzimet e arsyeshme dhe detyrimet që Huadhënësi mund të pësojë si pasojë e një mosplotësimi detyrimesh (duke përfshirë, por pa u kufizuar në ndonjë interes të paguar nga Huadhënësi për huadhënësit e fondeve të marra hua nga ai për të ruajtur një shumë të vonuar). Një vërtetim nga një nëpunës i autorizuar rregullisht i Huadhënësit që përcakton shumën e këtyre humbjeve, shpenzimet e arsyeshme dhe detyrimeve dhe bazën e llogaritjes së tyre, kur i paraqiten Huamarrësit (përveç ndonjë gabimi flagrant) do të jetë prova përfundimtare e shumës së këtyre humbjeve, shpenzimeve dhe detyrimeve, me kusht që ky vërtetim të mbështetet nga dokumente që japin të dhëna për këto humbje, shpenzime dhe detyrime, dhe këto vërtetime do të mbështeten nga dokumentet e caktuara.

Sapo të vihet në dijeni për këtë, Huamarrësi do t'i japë një njoftim me shkrim Huadhënësit për:

a) çdo rast të mosplotësimit të detyrimeve; ose

b) çdo kusht, ngjarje ose veprim që me dhënien e njoftimit ose kalimin e kohës ose tyre, ose përmbushjes së ndonjë kushti mund të çonte në ose përbënte një rast të mosplotësimit të detyrimeve.

9. GARANCITË DHE SIPËRMARRJET

9.1 Garancitë

Me qëllim që të nxitë Huadhënësin të hyjë në këtë Marrëveshje dhe për të parapaguar dhe mbajtur huan e parashikuar në këtë Marrëveshje, Huamarrësi bën garancitë e mëposhtme në datën e pranimit:

a) Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë është i autorizuar të veprojë në emër të dhe për Republikën e Shqipërisë dhe të vendosë Republikën e Shqipërisë para detyrimit ligjor përkatës. Rrjedhimisht, detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje janë detyrime të pakufizuara dhe të pakushtëzuara të Republikës së Shqipërisë. Republika e Shqipërisë mund të paditet në emër të saj në lidhje me detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje;

b) Huamarrësi nuk është në mosplotësim të ndonjë prej detyrimeve të tij të pagesës dhe nuk ka ndodhur dhe nuk po vazhdon asnjë rast i mosplotësimit të detyrimeve; ose

c) Huamarrësi ka autoritetin për të hyrë në këtë Marrëveshje dhe për të marrë hua, si më poshtë, dhe për të ekzekutuar, dorëzuar dhe realizuar këtë Marrëveshje dhe ka marrë të gjitha masat e nevojshme për të autorizuar termat dhe kushtet e kësaj Marrëveshjeje dhe për të autorizuar ekzekutimin, dorëzimin dhe realizimin e kësaj Marrëveshjeje që përbën një detyrim ligjor, të vlefshëm dhe detyrues të Huamarrësit, të zbatueshëm në përputhje me kushtet e tij; ose

d) ekzekutimi, dorëzimi dhe realizimi i kësaj Marrëveshjeje nuk shkel dispozitat e ndonjë ligji ose rregulloreje të zbatueshme për Huamarrësin ose ndonjë marrëveshje, kontratë ose sipërmarrje tjetër në të cilën Huamarrësi është palë ose që është detyruese për të ose asetet e tij; ose

e) të gjitha licencat, pëlqimet, regjistrimet ose aprovimet (qeveritare apo ndryshe) të nevojshme në lidhje me ekzekutimin, dorëzimin, realizimin, vlefshmërinë ose zbatueshmërinë e kësaj Marrëveshjeje janë marrë ose realizuar dhe janë në fuqi dhe efekt të plotë.

Garancitë e parashtruara më sipër do të vazhdojnë edhe pas ekzekutimit të kësaj Marrëveshjeje dhe konsiderohen të përsëritura në çdo datë të Huamarrjes dhe në çdo datë të pagesës së interesit.

9.2 Sipërmarrjet

Huamarrësi zotohet dhe merr përsipër me dhe për Huadhënësin, si më poshtë:

a) Të dhënat:

Huamarrësi do të marrë masa:

1. që (i) blerësi i projektit të mbajë të dhëna të mjaftueshme për të identifikuar mallrat dhe shërbimet e financuara nga huaja; (ii) blerësi i projektit informon për përdorimin e tyre në projekt; dhe (iii) blerësi i projektit regjistron progresin e projektit, duke përfshirë kostot e tij;

2. përfaqësuesit e Huadhënësit duhet të lejohen të inspektojnë projektin, sipërmarrjen e Blerësit të Projektit, mallrat dhe shërbimet e dhëna sipas Marrëveshjes së Blerjes dhe çdo të dhënë dhe dokument tjetër;

3. të informohet ose t'i japë Huadhënësit të gjithë informacionin që Huadhënësi kërkon në lidhje me shpenzimet e huas, projektin dhe mallrat dhe shërbimet e dhëna sipas Marrëveshjes së Blerjes.

b) *Pari passu* dhe pengu negativ

Detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje klasifikohen të paktën *pari passu* dhe njëjloj me të gjitha detyrimet e tjera të papaguara të pasiguruara dhe të pavarura të Huamarrësit. Nga data e pranimit dhe për sa kohë që një pjesë e huas mbetet e papaguar, Huamarrësi nuk do të krijojë ose bjerë

dakord për të krijuar ndonjë hipotekë, detyrim, peng, të drejtë mbajtjeje ose interes tjetër garancie mbi të gjithë ose një pjesë të aseteve të tij për të siguruar detyrime ose garanci të ndonjë detyrimi, nëse huaja nuk sigurohet në mënyrë të barabartë dhe përpjesëtimore, të pranueshme për Huadhënësin.

c) Amendimi i Marrëveshjes së Blerjes

Huamarrësi nuk do të bëjë, lejojë ose miratojë ndonjë amendim, ndryshim, modifikim ose përfundim të Marrëveshjes së Blerjes pa miratimin paraprak me shkrim të Huadhënësit.

10. LIGJI RREGULLUES DHE MOSMARRËVESHJET

a) Kjo Marrëveshje rregullohet nga ligji i Republikës së Austrisë.

b) Të gjitha mosmarrëveshjet që lindin në lidhje me këtë Marrëveshje, duke përfshirë lidhjen e saj, vlefshmërinë dhe të drejtat dhe detyrat e palëve, si më poshtë, zgjidhen përfundimisht nga tre arbitra, sipas rregullave të pajtimit dhe arbitrazhit në atë kohë në fuqi të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë në Paris.

c) Vendi i arbitrazhit do të jetë Parisi. Gjuha që duhet të përdoret në procedimet e arbitrazhit do të jetë anglishtja.

d) Vendimi i arbitrazhit përcakton përgjegjësinë e palëve për kostot e shkaktuara nga palët.

e) Arbitrat do të bëjnë të gjitha përpjekjet për të realizuar procedimet dhe për të përgatitur vendimin e tyre, në mënyrë që ta bëjnë vendimin të zbatueshëm sipas ligjit.

f) Gjykimi për vendimin mund të zhvillohet në çdo gjykatë që ka juridiksion ose në atë gjykatë mund të bëhet kërkesë për një pranim gjyqësor të vendimit dhe një urdhër përmbarimi, sipas rastit.

g) Nëse Huadhënësi merr masa ligjore (duke përfshirë padinë, arbitrazhin, sekuestrimin, ekzekutimin ose ndonjë zbatim tjetër ose masë mbrojtëse) kundër Huamarrësit në lidhje me ndonjë çështje sipas kësaj Marrëveshjeje, Huamarrësi me anë të kësaj heq dorë nga çdo e drejtë imuniteti që mund të ketë Huamarrësi.

Huamarrësi cakton Ambasadën e Republikës së Shqipërisë si agjentin e saj veprues në Vjenë (aneksi 7).

11. TË PËRGJITHSHME

11.1 Njoftimet

Të gjitha njoftimet, kërkesat dhe komunikimet e tjera do të jenë efektive në rast të një njoftimi me shkrim me letër rekomande kur merret ose në rast të njoftimit me faks, kur merret nga pala për të cilën ky njoftim, kërkesë ose komunikim tjetër kërkohet ose lejohet të jepet ose bëhet sipas kësaj Marrëveshjeje, drejtuar Huamarrësit ose Huadhënësit përkatësisht në adresat e tyre të përcaktuara në aneksin 1 ose në një adresë tjetër që ndonjë prej tyre mund të përcaktojë më pas me shkrim për tjetrin, në përputhje me këtë seksion 11.1.

11.2 Titujt përshkrues

Titujt në këtë Marrëveshje janë vetëm për lehtësi reference dhe nuk përcaktojnë ose kufizojnë dispozitat e saj.

11.3 Heqjet dorë, mjetet kumulative

Asnjë paafësi ose vonesë nga ana e Huadhënësit në ushtrimin e ndonjë të drejte, kompetence ose privilegji, si më poshtë, dhe asnjë kurs transaksioni ndërmjet Huamarrësit dhe Huadhënësit nuk do të funksionojë si heqje dorë nga kjo; as një ushtrim i vetëm ose i pjesshëm i ndonjë të drejte, kompetence ose privilegji, si më poshtë, nuk do të përjashtojë një ushtrim tjetër ose të mëtejshëm të tyre ose ushtrimin e ndonjë të drejte, kompetence ose privilegji tjetër. Të drejtat dhe mjetet ligjore në këtë marrëveshje të parashikuara shprehimisht janë kumulative dhe nuk janë ekskluzive për ndonjë të drejtë ose mjet ligjor që Huadhënësi do të kishte ndryshe. Në çdo rast, asnjë njoftim ose kërkesë ndaj Huamarrësit nuk autorizon Huamarrësin për ndonjë njoftim ose kërkesë tjetër ose të mëtejshme në lidhje me të njëjtat rrethana, ose nuk përbën një heqje dorë nga të drejtat e Huadhënësit të ndonjë veprimi tjetër ose të mëtejshëm në lidhje me këto rrethana pa njoftim ose kërkesë.

11.4 Pavlefshmëria e pjesshme

Nëse ndonjë prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje do të çmohet nga ndonjë gjykatë ose autoritet tjetër kompetent gjyqësor si e pazbatueshme, vlefshmëria, ligjshmëria dhe zbatueshmëria e dispozitave të mbetura të saj nuk do të cenohen ose preken në ndonjë mënyrë nga kjo dhe palët do të bëjnë të gjitha përpjekjet për të rishikuar dispozitën e pavlefshme, në mënyrë që ta bëjnë atë të zbatueshme në përputhje me qëllimin e shprehur në të.

11.5 Caktimi

Huamarrësi nuk mund të caktojë ose transferojë të gjithë ose ndonjë pjesë të të drejtave dhe detyrimeve të tij, si më poshtë, pa miratimin paraprak me shkrim të Huadhënësit.

Huadhënësi mund të caktojë të drejtat dhe detyrimet e tij, si më poshtë: (i) pa miratimin e Huamarrësit, nëse përfituesi është OeKB-ja ose (në rastin vetëm të mosplotësimit të detyrimeve) çdo bankë ose institucion tjetër financiar; dhe (ii) me miratimin paraprak me shkrim të Huamarrësit që nuk do të pengohet në mënyrë të paarsyeshme ndonjë përfitues tjetër.

11.6 Konfidencialiteti

Me anë të kësaj Marrëveshjeje Huamarrësi bie dakord që Huadhënësi të ketë të drejtën për të paraqitur në një mënyrë të aplikueshme nga bankat të gjithë informacionin që ai merr në lidhje me këtë Marrëveshje ose marrëdhënien e tij të punës me Huamarrësin, veçanërisht në interes të një mbrojtjeje të arsyeshme të kreditorëve për bankat, institucionet e përbashkëta bankare ose organizatat e përzgjedhura për mbrojtjen e kreditorëve.

Me anë të kësaj Marrëveshjeje, Huamarrësi bie dakord më tej që Huadhënësi të ketë të drejtën për të dhënë informacion që rezultojnë nga kjo Marrëveshje ose marrëdhënia e punës së Huadhënësit me Huamarrësin për personat ose subjektet e mëposhtme:

- a) çdo anëtar të grupit të subjekteve të Huadhënësit;
- b) një përfitues i mundshëm ose për çdo person ose subjekt tjetër që mund të propozojë hyrjen në marrëdhënie kontraktuale me Huadhënësin në lidhje me këtë Marrëveshje;
- c) OeKB-ja dhe Republika e Austrisë; dhe
- d) çdo person, autoritet ose subjekt tjetër, të cilit Huadhënësi i kërkohet të japë këtë informacion sipas ndonjë ligji ose urdhri gjykatë ose autoriteti tjetër gjyqësor ose organi rregullator me udhëzimet e të cilit duhet të pajtohet Huadhënësi.

11.7 Amendimet e Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje nuk mund të modifikohet ose amendohet përveçse me instrumente me shkrim.

12. Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi me nënshkrimin nga palët dhe ratifikimin nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe botimin në Fletoren Zyrtare Shqiptare.

Në dëshmi të kësaj palët kanë ekzekutuar këtë Marrëveshje në datën e shkruar më parë më sipër në dy prej origjinaleve në gjuhën angleze dhe versioni në gjuhën angleze do të jetë detyrues dhe do të ketë përparësi mbi përkthimet.

ANEKSI 1 PALËT

HUAMARRËSI

Emri: Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë
që vepron në emër të Republikës së Shqipërisë si Huamarrësi
(përfaqësuar nga Ministria e Financave)

Adresa: Ministria e Financave

Bul. "Dëshmorët e Kombit", nr. 1

Tiranë, Shqipëri

Tel: (355 4) 222 8494

Faks: (355 4) 222 8405

HUADHËNËSI

Emri: UniCredit Bank Austria AG

Adresa: Schottengasse 6-8, 1010 Vienna

Tel: +43 (0)5 05 05-87332

Faks: +43 (0) 5 05-50399

Departamenti përgjegjës: 8243 Financimi i Eksportit

Në vëmendje të: Znj.Doris Pignitter

ANEKSI 2

1. Projekti

Përmirësimi i Departamentit të Neurokirurgjisë në spitalin "Nënë Tereza", Tiranë

2. Marrëveshja e Blerjes

Një marrëveshje e datës 20 tetor, 2010 ndërmjet AME International GmbH (Eksportuesi i projektit) dhe Ministrisë së Shëndetësisë të Republikës së Shqipërisë (Blerësi i projektit) në shumën prej 7,100,000 euro (shtatë milionë e njëqind mijë euro) në lidhje me projektin.

ANEKSI 3

1. Shuma e kredisë (seksioni 2.2)

Një shumë që nuk tejkalon 7,100,000 euro (shtatë milionë e njëqind mijë euro)

2. Periudha e disponueshmërisë (seksioni 2.2)

Nga data e mbylljes (siç përcaktohet në seksionin 7) deri në ditën që bie 18 muaj pas datës së mbylljes.

3. Interesi (seksioni 3.1)

0.0 për qind në vit

4. Kamatëvonesa (seksioni 3.3)

3 muaj EURIBOR plus një marzh prej 2% p.a.

5. Tarifa e angazhimit (seksioni 4.1)

0.5 (zero pikë pesë për qind në vit)

6. Tarifa e drejtimit (seksioni 4.2)

0.5 (zero pikë pesë për qind) e sheshtë nga shuma e kredisë

7. Primi i garancisë (seksioni 4.3)

i) Primi i garancisë së OeKB-së i pagueshëm i parapaguar

38,138.45 euro

Shuma përfundimtare do të përcaktohet nga OeKB-ja me marrjen e garancisë fillestare. Në rast se shuma përfundimtare ndryshon nga shuma e përcaktuar, Huamarrësi do të paguajë diferencën (nëse ka) brenda 30 ditësh kalendarike pasi të jetë njoftuar për këtë nga Huadhënësi.

ii) Primi i garancisë së OeKB-së të pagueshëm si marzh

1.042 për qind në vit

Sipas OeKB-së, norma e mësipërme mbështetet nga një grant shtesë që arrin shumën prej rreth 390,216 euro nga Ministria Federale Austriake e Financave. Norma përfundimtare dhe granti, nëse ka, do të përcaktohen nga OeKB-ja me marrjen e garancisë fillestare.

8. Tarifa e drejtimit e OeKB-së

1,440 euro në lidhje me sigurimin e kredisë së eksportit

9. Datat e shlyerjes së detyrueshme (seksioni 5.1)

Shlyerja duhet të bëhet në deri 20 këste gjashtëmujore të barabarta të njëpasnjëshme, i pari bëhet i kërkueshëm 54 muaj pas datës së përkohshme të pranimit, në çdo rast jo më vonë se 72 muaj pas datës së mbylljes.

10. Shuma e parapagimit opsional (seksioni 5.2)

500,000 euro

11. Periudha e mbylljes (seksioni 7)

Një periudhë që fillon në datën e pranimit maksimumi deri 60 (gjashtëdhjetë) ditë kalendarike pas datës së pranimit.

ANEKSI 4 PROCEDURA E PAGESËS

Me anë të kësaj, Huamarrësi autorizon Huadhënësin në mënyrë të përvokueshme t'i paguajë eksportuesit të projektit shumën maksimale totale të kredisë të përmendur në aneksin 3, me paraqitjen e dokumenteve të mëposhtme në ambientet e Huadhënësit:

Parapagimi:

15 % (pesëmbëdhjetë për qind) të shumës së Marrëveshjes së Blerjes që është 1.065.000,00 euro (me fjalë: një milion e gjashtëdhjetë e pesë mijë) janë të pagueshme si parapagim, sipas kërkesës, me paraqitjen e

- Fatura e parapagimit të eksportuesit të projektit në tri (3) origjinale dhe në tri (3) kopje;
- Kopje të obligacionit të përmbushjes të lëshuar nga banka austriake në vlerën 5% të Marrëveshjes së Blerjes;
- Kopje të garancisë së parapagimit të lëshuar nga banka austriake në shumën 15% të Marrëveshjes së Blerjes.

Pagesa për transportin

80% (tetëdhjetë për qind) e shumës së Marrëveshjes së Blerjes që është 5,680,000.00 (në fjalë: pesë milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë mijë) janë të pagueshme me paraqitjen e dokumenteve të mëposhtme:

- Faturës tregtare të eksportuesit të projektit në tri (3) origjinale, të gjitha të nënshkuara rregullisht nga eksportuesi i projektit dhe tri (3) kopje;
- Vërtetimit të sigurimit në një (1) origjinal dhe tri (3) kopje;
- Listës së paketimit në një (1) origjinal dhe tri (3) kopje;
- Dokumenti përfundimtar ndërkombëtar i transportit me kamion (CMR); kopje për dërguesin, e vulosur dhe nënshkuar fillimisht nga transportuesi, me shënimin “Ngarkesë e parapaguar” dhe numrin e kontratës që tregon si marrës spitalin “Nënë Tereza”, Departamentin e Neurokirurgjisë, Tiranë, Shqipëri;

dhe/ose

Grupin e plotë të fletëngarkesës oqeanike “Në bord” ose fletëngarkesën e transportit të kombinuar FIATA në 3 (tri) kopje origjinale dhe tri (3) kopje të panegociueshme të bëra jashtë radhe, me xhirim në të bardhë, që njoftojnë blerësin e projektit, ku tregojnë si port destinacioni çdo port detar në Shqipëri, duke treguar numrin e kontratës;

dhe/ose

Faturën e mallrave të lëshuar nga një linjë ajrore ndërkombëtare në një (1) kopje origjinale dhe tri (3) kopje, që tregon si destinacion çdo aeroport në Shqipëri, duke treguar ngarkesën e parapaguar, numrin e kontratës dhe që tregon si marrës spitalin “Nënë Tereza”, Departamenti i Neurokirurgjisë, Tiranë, Shqipëri, ku secili deklaron portin/aeroportin e destinacionit në Shqipëri, ngarkesën e parapaguar dhe numrin e kontratës.

Pagesa për COHO-n

5% (pesë për qind) të shumës së kontratës së blerjes që është 355,000.00 euro (me fjalë: treqind e pesëdhjetë e pesë mijë) janë të pagueshme me paraqitjen e:

- Faturës tregtare të eksportuesit të projektit në 3 (tri) kopje origjinale dhe 3 (tri) kopje; dhe
- Tri (3) kopje të COHO-s përkatëse.

Huadhënësi do të ketë të drejtën të mbështetet në çdo dokument që ata e konsiderojnë si të vërtetë dhe të saktë dhe që është nënshkruar ose dërguar nga personi kompetent. Huadhënësi nuk merr përsipër asnjë përgjegjësi ose detyrim për formën, mjaftueshmërinë, saktësinë, vërtetësinë, falsifikimin ose efektin ligjor të ndonjë dokumenti (eve) ose për kushtet e përgjithshme dhe/ose të veçanta të përcaktuara në dokument; (e) ose vendoset mbi to; as nuk merr përsipër ndonjë përgjegjësi ose detyrim për përshkrimin, sasinë, peshën, cilësinë, gjendjen, paketimin, dorëzimin, vlerën ose ekzistencën e mallrave ose shërbimeve të përfaqësuara nga ndonjë dokument; (e) ose për mirëbesim ose veprime dhe/ose mosveprime, aftësi paguese, performance ose pozicioni të dërguesve, transportuesve, marrësve ose siguruesve të mallrave ose çdo personi tjetër.

Lejohen ngarkesat e pjesshme dhe paraqitja e pjesshme e dokumenteve.

Huadhënësi do t'i japë Huamarrësit njoftim me shkrim, pasi të jetë bërë një huamarrje për eksportuesin e projektit.

Pas kryerjes së një huamarrjeje për eksportuesin e projektit, Huadhënësi do t'i dërgojë dokumentet përkatëse Huamarrësit me anë të një shërbimi të veçantë korrier.

ANEKSI 5 OPINION LIGJOR (Model)

Nga: Ministri i Drejtësisë i Republikës së Shqipërisë
Për: UniCredit Bank Austria AG

Datë.....

Unë,, që veproj në cilësinë time si Ministër i Drejtësisë i Republikës së Shqipërisë, i referohem Marrëveshjes së Kredisë së Eksportit për një hua të butë Nr.230.916 në një shumë prej 7,100,000 euro (Marrëveshja) të datës....2010 dhe të bërë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë që vepron në emër të Republikës së Shqipërisë si Huamarrësi (përfaqësuar nga Ministria e Financave) si Huamarrësi (Huamarrësi) dhe UniCredit Bank Austria AG si Huadhënësi (Huadhënësi). Unë nuk shpreh asnjë opinion në lidhje me ligjet e ndonjë juridiksioni të ndryshëm nga ai i Republikës së Shqipërisë.

Unë kam shqyrtuar një kopje të nënshkruar dhe të ekzekutuar të Marrëveshjes dhe ato dokumente të tjera, që i kam çmuar të nevojshme dhe të përshtatshme për të shqyrtuar, me qëllim që të mund të jap këtë opinion. Termat e përkufizuar në Marrëveshje kanë të njëjtin kuptim nëse nuk përcaktohet ndryshe në të.

Sa më sipër, jam i mendimit që:

a) Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë është i autorizuar për të vepruar në emër të dhe për Republikën e Shqipërisë dhe për të vendosur Republikën e Shqipërisë para detyrimit ligjor përkatës. Rrjedhimisht, detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje janë në mënyrë të pakufizuar dhe të pakushtëzuar detyrime të Republikës së Shqipërisë. Republika e Shqipërisë mund të paditet në emër të saj në lidhje me detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje.

b) Ministria e Financave është e autorizuar për të vepruar në emër të Huamarrësit dhe për të vendosur Huamarrësin para detyrimit ligjor përkatës. Rrjedhimisht, të gjitha detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje janë detyrime të vlefshme dhe ligjorisht detyruese dhe të zbatueshme të Huamarrësit. Huamarrësi ka kapacitetin për të paditur ose për t'u paditur në emrin e tij.

c) Huamarrësi ka kompetencën për të hyrë në dhe për të realizuar Marrëveshjen. Huadhënësi ka marrë të gjitha masat e nevojshme (qeveritare dhe ndryshe) për të autorizuar nënshkrimin e Marrëveshjes sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në të dhe hyrjes në ekzekutim, dorëzimit dhe realizimit të Marrëveshjes.

d) Marrëveshja është nënshkruar nga Z.....në cilësinë e tij si Ministri i Financave të Republikës së Shqipërisë.

e) Marrëveshja e nënshkruar nga Ministria e Financave në emër të Huamarrësit përbën detyrime ligjore të vlefshme dhe detyruese të Huamarrësit të zbatueshme në gjykatat e Republikës së Shqipërisë në përputhje me kushtet e tij.

f) Personi ose personat që nënshkruajnë Marrëveshjen, duke nënshkruar ose vërtetuar çdo dokument tjetër në lidhje me Marrëveshjen kanë të drejtën e plotë dhe janë të autorizuar rregullisht për ta bërë këtë në emër të Huamarrësit.

g) Ekzekutimi dhe realizimi i Marrëveshjes dhe transaksioneve të parashikuara në të, nuk janë në kundërshtim me: (i) ndonjë ligj, rregullore ose urdhër zyrtar ose gjyqësor; (ii) traktat, marrëveshje ose dokument ose instrument tjetër në të cilin Huamarrësi dhe/ose Republika e Shqipërisë është palë ose që është detyrues për të ose ndonjë prej aseteve të saj përkatëse.

h) Të gjitha autorizimet, miratimet (duke përfshirë, nëse është e nevojshme, miratimet e kontrollit të këmbimit), pëlqimet, licencat, përjashtimet, depozitimet, regjistrimet, noterizimet dhe kërkesat e tjera të institucioneve qeveritare, gjyqësore dhe publike dhe autoriteteve të nevojshme ose të këshillueshme në lidhje me ekzekutimin, dorëzimin, vlefshmërinë dhe realizimin e Marrëveshjes ose ndonjë pagese që duhet të bëhet sipas saj, janë marrë ose bërë dhe janë në fuqi dhe efekt të plotë dhe Huamarrësi ka autoritetin e plotë për të bërë të gjitha pagesat sipas Marrëveshjes në euro.

i) Të gjitha shumat e pagueshme nga Huamarrësi sipas Marrëveshjes mund të bëhen pa zbritje për dhe në llogari të ndonjë takse, tarife, zbritjeje ose pagese nga Republika e Shqipërisë, ndonjë nënndarje politike ose autoriteti tatimor. Në rast të një mbajtjeje në lidhje me pagesat e interesit sipas Marrëveshjes, detyrimi i Huamarrësit për të paguar shumat shtesë sipas Seksionit 6.4 është i vlefshëm dhe i zbatueshëm.

j) Kjo Marrëveshje është ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe është botuar në Fletoren Zyrtare Shqiptare, të quajtur Fletore Zyrtare dhe nuk është i nevojshëm ose i këshillueshëm për të garantuar ligjshmëri, vlefshmëri, zbatueshmëri ose pranueshmëri si provë që Marrëveshja të depozitohet, shënohet ose regjistrohet pranë një autoriteti ose agjencie tjetër qeveritare në Republikën e Shqipërisë.

k) Zgjedhja e ligjit të Republikës së Austrisë për të rregulluar Marrëveshjen është një zgjedhje e vlefshme e ligjit dhe do të njihet dhe zbatohet në çdo gjykatë në Republikën e Shqipërisë.

Huamarrësi i nënshtrohet të drejtës civile në lidhje me detyrimet e tij sipas Marrëveshjes. Lidhja dhe realizimi i Marrëveshjes nga Huamarrësi përbën akte private dhe tregtare. Heqja dorë nga imuniteti në seksionin 10 (g) të Marrëveshjes është i vlefshëm dhe detyrues për Huamarrësin.

l) Nuk është e nevojshme sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë: (i) me qëllim që t'i mundësojë Huadhënësit të zbatojë të drejtat e tij përkatëse sipas Marrëveshjes; ose (ii) për shkak të ekzekutimit, dorëzimit, realizimit ose zbatimit të Marrëveshjes, që Huadhënësi është i licencuar, i kualifikuar ose i autorizuar për të kryer biznes në Republikën e Shqipërisë.

Huadhënësi nuk është dhe as nuk do të jetë rezident, me banim, të kryejë biznes ose t'i nënshtrohet tatimit në Republikën e Shqipërisë për shkakun e vetëm të ekzekutimit, dorëzimit, realizimit ose zbatimit të Marrëveshjes.

m) Dispozitat e seksionit 10 të Marrëveshjes janë të ligjshme, të vlefshme dhe detyruese sipas ligjit të Republikës së Shqipërisë.

Gjykatat e Republikës së Shqipërisë do të njohin çdo vendim dhe/ose vendim arbitrazhi në lidhje me Marrëveshjen si të vlefshëm dhe të formës së prerë dhe do të zbatojnë këto vendime dhe/ose vendime arbitrazhi.

Një vendim i caktuar në euro do të njihet dhe zbatohet në Republikën e Shqipërisë.

Sipas informacionit që kam në dispozicion, asnjë çështje gjyqësore, arbitrazh ose procedim administrativ nuk është aktualisht ekzistues ose pezull ose, sipas dijenisë tonë, nuk kërcënon Huamarrësin që do të kishte ose mund të kishte rezultuar në një ndryshim të rëndë material të situatës financiare ose korporative të Huamarrësit.

n) Marrëveshja dhe të gjitha dokumentet e tjera nuk përmbajnë ndonjë dispozitë që do të çmohet e pazbatueshme sipas ligjit të Republikës së Shqipërisë.

o) Në çdo rast, detyrimet e Huamarrësit sipas Marrëveshjes do të klasifikohen *pari passu* me të gjitha detyrimet e tjera të Huamarrësit, përveç atyre detyrimeve që përzgjidhen detyrimisht me ligj.

Ky opinion ligjor është dhënë për përfitimin e vetëm të Huadhënësit dhe mund të mos i zbulohet asnjë personi tjetër.

Me respekt

ANEKSI 6

KONFIRMIMI QË MARRËVESHJA E BLERJES ËSHTË NË FUQI DHE EFEKT TË PLOTË

[Huadhënësi]

Ref: Marrëveshja e kredisë së eksportit për një hua të butë nr.230.916 në një shumë prej 7,100,000 euro (“Marrëveshja”) e datës....2010 dhe e lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë që vepron në emër të Republikës së Shqipërisë si Huamarrësi (përfaqësuar nga Ministria e Financave) si Huamarrësi (“Huamarrësi”) dhe UniCredit Bank Austria AG si Huadhënësi (“Huadhënësi”).

Të nderuar zotërinj

Me anë të kësaj iu konfirmojmë se Marrëveshja e Blerjes [nr.....] e lidhur më [.....] ndërmjet [.....] dhe [.....] ka hyrë në fuqi më [.....].

Vjenë,.....

.....

[Eksportuesi i projektit]

ANEKSI 7

PRANIMI I EMËRIMIT TË AGJENTIT VEPRUES

[Huadhënësi]

Ref: Marrëveshja e kredisë së eksportit për një hua të butë nr.230.916 në një shumë prej 7,100,000 euro (Marrëveshja”) e datës....2010 dhe e lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë që vepron në emër të Republikës së Shqipërisë si Huamarrësi (përfaqësuar nga Ministria e Financave) si Huamarrësi (Huamarrësi) dhe UniCredit Bank Austria AG si Huadhënësi (Huadhënësi).

Të nderuar zotërinj

Si ambasador i Republikës së Shqipërisë në Vjenë, Republika e Austrisë, unë pranoj në emrin tim dhe në emrin e Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë emërimin si agjent i autorizuar i Huamarrësit për të shërbyer si agjent veprues sipas agjentit të kredisë së eksportit.

Adresa ime në Vjenë është:.....

Nëse ka ndonjë ndryshim në adresën time, do iu njoftoj me shkrim pa vonesë.

Me respekt

.....

Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Austri

Vendi, data.....

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-eksponitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 29.3.2011
Doli nga shtypi më 31.3.2011

Tirazhi: 1700 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2011

Çmimi 44 lekë